




rrjeti ballkanik për përfaqësim gjatë menaxhimit të e-mbeturinave

# pajisjet elektronike dhe e-mbeturinat

udhëzuesi për përfaqësim







Rrjeti ballkanik për përfaqësim gjatë menaxhimit të e-mbeturinave

# pajisjet elektronike dhe e-mbeturinat

udhëzuesi për përfaqësim

Rrjeti ballkanik për përfaqësim gjatë menaxhimit të e-mbeturina është i financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa implementohet nga Fondacioni Metamorfozis – Maqedoni, si lider, në partneritet me BlueLink - Bullgari, Computer Aid – Mbretëria e Bashkuar, ZaMirNet – Kroaci dhe PROTEKTA – Serbi



Skopje, 2011



**sq.bewman.eu**

Për botuesin: Bardhyl Jashari, Drejtor

Autore: Haley Bowcock, Computer Aid International

Redaktore: Elena Ignatova, Fondacioni Metamorfozis

Dizajni: plasticart design & video

Rrjeti ballkanik për përfaqësim gjatë menaxhimit të e-mbeturinave është i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij publikacioni nuk pasqyron domosdoshmërisht mendimin e Bashkimit Evropian.

Pronar i të drejtave autoriale të teksteve të botuara në këtë udhëzues është fondacioni Metamorfozis. Versioni digjital i këtij publikimi është i licencuar sipas licencës Creative Commons Attribution –Vepra jokomerciale 2.5 Licenca Maqedoni. <http://creativecommons.org/licenses/by-nc/2.5/mk/deed.en>

# Përmbajtja

<b>Ç'janë e-mbeturinat?</b>	4
<b>Ku qëndron problemi? Pse pajisjet elektronike dhe e-mbeturinat kërkojnë trajtim special</b>	4
Problemi #1: Afati i shkurtër e jetesës, pasojat afatgjate	4
Problemi #2: Produktet toksike bëhen mbeturina toksike	7
Problemi #3: Pajisjet elektronike përmbajnë materiale të çmueshme dhe të rralla	9
Problemi nr.4: Menaxhimi i keq i e-mbeturinave u kushton njerëzve dhe planetit	9
<b>Cila është zgjidhja? Si të minimizohen ndikimet e pajisjeve elektronike dhe të e-mbeturinave</b>	12
Aktivitete për prodhuesit	13
Aktivitetet për palët e tjera	15
<b>Si t'i shndërrojmë këto zgjidhje në realitet?</b>	
<b>Lobimi për përfaqësim për e-mbeturinat në praktikë</b>	19
Qasjet dhe aktivitetet për përfaqësim	19
Veglat për përfaqësim	23
<b>Resurset dhe informatat plotësuese</b>	28
Instrumentet kyçe ligjore dhe politike	28
Iniciativa të rëndësishme	31
OJQ-të që merren me çështjet e pajisjeve elektronike dhe të e-mbeturinave	31
<b>Referimet</b>	33



# Parathënie

Mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE), ose 'e-mbeturinat', janë një sfidë në rritje për qeveritë anëmbanë botës. Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara<sup>1</sup> vlerëson se diku rreth 50 milionë tonë e-mbeturina krijohen çdo vit nëpër botë. Duke pasur parasysh trendet aktuale në dizajnin dhe prodhimin e pajisjeve elektronike, të cilat japin shtytje për cikle shumë të shpeshta të zëvendësimit, gjenerimi i këtyre mbeturinave nuk do të zvogëlohet edhe për një kohë të caktuar.

Mungesa e metodave të sigurta për trajtimin e problemit të e-mbeturinave në shumë vende, d.t.th. se komunitetet dhe mjedisi vazhdojnë ta paguajnë çmimin për dizajne toksike dhe joefikase. Poashtu, prodhimi i pajisjeve elektronike, kërkon shumë materiale dhe energji, duke pasur ndikim të madh ekologjik dhe social rreth e përqark zinxhirit të prodhimit. Ndikimet bëhen edhe më të mëdha kur merret parasysh fakti se shumë materiale që janë jashtëzakonisht të rëndësishme për elektronikën moderne, janë të rralla dhe ka rrezik të vazhdueshëm për furnizim me to.

Është e qartë se, mënyra se si i dizajnojmë, i prodhojmë dhe i përdorim pajisjet elektronike, si dhe si i menaxhojmë ato pas daljes së tyre nga përdorimi, duhet të ndryshojë, nëse dëshirojmë të vazhdojmë t'i vjelim përfitimet që i jell zhvillimi teknologjik, në mënyra që nuk i dëmtojnë njerëzit dhe planetin.

Në këtë drejtim janë bërë hapa në aspekt të politikave, siç është Direktiva e Bashkimit Evropian për MPEE (WEEE Directive), që në thelbin e saj e ka përgjegjësinë e prodhuesve që t'i mbulojnë harxhimet e menaxhimit pas daljes nga përdorimi të prodhimeve elektronike. Megjithatë, disa shtete akoma nuk kanë definuar instrumente të ngjashme ligjore, e gjithashtu vazhdojmë të shohim se si e-mbeturinat po shkojnë prej vendeve të pasura, që kanë kapacitet ta trajtojnë atë në mënyrë të sigurt dhe adekuate, në vendet që nuk kanë kapacitet të tillë. Fotografitë me grumbuj të e-mbeturinave duke u djegur pranë vendeve ku jetojnë familjet dhe ku luajnë (e shpesh, ku punojnë) fëmijët, në vendet pa ligje për e-mbeturina ose pa kapacitete për menaxhim të sigurt të tyre, ofrojnë një dëshmi shqetësuese të distribuimit jo të drejtë të harxhimeve të revolucionit digjital.

Ky udhëzues ofron informata dhe vegla që do t'u mundësojnë aktorëve nga shoqëria civile të nxisin ndryshime që do t'i minimizojnë ndikimet ekologjike, shëndetësore dhe sociale të pajisjeve elektronike dhe të e-mbeturinave. Edhe pse një pjesë e përbajtjes është specifike për shtetet që janë pjesë e Rrjetit ballkanik për përfaqësim gjatë menaxhimit të e-mbeturinave (BEWMAN), pjesa më e madhe e përbajtjeve mund të zbatohet për cilindo qoftë grup që dëshiron të bëjë ndryshime pozitive në politikat dhe praktikat që kanë të bëjnë me e-mbeturinat në shtetet e tyre.

Rrjeti ballkanik për përfaqësim gjatë menaxhimit të e-mbeturinave (Balkan E-Waste Management Advocacy Network - BEWMAN) është një projekt dyvjeçar, i inicuar nga Fondacioni Metamorfozis ([www.metamorphosis.org.mk](http://www.metamorphosis.org.mk)) dhe i kofinancuar nga Fondi për shoqëri civile i programit IPA 2008 i Bashkimit Evropian, qëllimi i përgjithshëm i të cilit është ta përmirësojë kornizën ligjore dhe institucionale që do të kontribuojë për menaxhimin adekuat të e-mbeturinave në Maqedoni, Serbi, Kroaci dhe Bullgari, në përputhje me legjisllacionin dhe standartet relevante të BE-së. Partnerë të projektit janë Computer Aid International (Mbretëria e Bashkuar), ZaMirNet (Kroaci), shoqata Qendra për zhvillim të shoqërisë civile PROTECTA (Serbi), dhe Fondacioni Bluelink (Bullgari). Ky udhëzues është përgatitur në kuadër të projektit Rrjeti ballkanik për përfaqësim gjatë menaxhimit të e-mbeturinave ([www.e-otpad.mk](http://www.e-otpad.mk)).

## Falënderime

Ky udhëzues nuk do të mund përgatitej pa ndihmën e Fondit për shoqëri civile të programit IPA 2008 të. Poashtu e falënderojmë edhe Isobel Foulsham-in për ndihmën e dhënë gjatë zhvillimit të përbajtjes dhe pamjeve grafike.

## Ç'janë e-mbeturinat?

E-mbeturina është një term i përgjithshëm që përdoret për t'i përshkruar llojet e ndryshme të pajisjeve të vjetra, në fund të jetës së tyre ose të dala nga përdorimi, që përmbajnë komponente që punojnë me rrymë elektrike.<sup>2</sup> I përfshin një numër të madh të pajisjeve të hedhura, jo vetëm ato që kyçen në rrjetin elektrik, por edhe ato produkte që punojnë me bateri, me energji të fituar nga era, apo me energji solare.<sup>3</sup> Këtu përfshihen shumë gjëra, duke filluar prej aparateve shtëpiake, si frigoriferët dhe tosterët, duke vazhduar me pajisjet e TKI-së, siç janë laptopët dhe celularët e mençur, pastaj pajisjet e konsumatorëve siç janë televizorët dhe mp3 plejerët, e deri te veglat si p.sh. turjelat elektrike dhe makinat për qepje – dhe lista vazhdon edhe më tutje.<sup>4</sup>

## Ku qëndron problemi? Pse pajisjet elektronike dhe e-mbeturinat kërkojnë trajtim special

Pajisjet elektronike kanë karakteristika të veçanta që e bëjnë prodhimin dhe shfrytëzimin e tyre, burim me ndikim të madh ekologjik dhe social, dhe prandaj ato janë problematike dhe sfiduese si mbeturina.

- |                     |  |
|---------------------|--|
| <b>Problemi #1.</b> | Dizajni i keq dhe marketingu agresiv nga ana e prodhuesve të pajisjeve elektronike shkaktojnë gjenerim shumë të shpejtë të mbeturinave, dhe pasoja të mëdha për mjedisin dhe shoqërinë |
| <b>Problemi #2.</b> | Pajisjet elektronike përmbajnë shumë substance toksike (helmuese) që i bën e-mbeturinat toksike  |
| <b>Problemi #3.</b> | Pajisjet elektronike përmbajnë materiale të çmueshme e që janë gjithnjë e më të rralla   |
| <b>Problemi #4.</b> | Shumica e e-mbeturinave menaxhohen në mënyrë të keqe, që dotë thotë se komunitetet dhe mjedisi e paguajnë çmimin e dizajnit toksik dhe joefikas  |

## Problemi #1: Afati i shkurtër e jetesës, pasojat afatgjate

Karakteristikë e industrisë elektronike është ajo që, nga njëra anë, ka zhvillim shumë të shpejtë teknologjik, ndërsa nga ana tjetër, nuk arrijnë që t'i dizajnojnë prodhimet e tyre duke i marrë parasysh ndikimet e prodhimeve gjatë tërë afatit të tyre jetësor, duke e përfshirë edhe kohën kur bëhen mbeturina. Kjo rezultoi me pajisje që janë jashtëzakonisht të ndërlikuara në dizajnin dhe përbërjen e tyre, që përmbajnë koleksion mahnitës të materialeve, disa prej tyre të rrezikshme dhe që nuk mund të trajtohen lehtë kur bëhen mbeturina.<sup>5</sup> Prodhimi i tyre, poashtu, kërkon sasi të mëdha të energjisë, të materialeve dhe të ujit, si dhe gjeneron sasi të mëdha të emetimeve të mbeturinave (shih Kutinë 1).

<sup>2</sup> Empa 2009

<sup>3</sup> Agjencia e mjedisit jetësor (Environment Agency) 2010

<sup>4</sup> Një definicion teknik që përdoret zakonisht në legjislacionin për e-mbeturina të Bashkimit Evropian (BE). Për këtë, dhe listën e kategorive të e-mbeturinave të definuara sipas Direktivës së BE-së për Mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike të vitit 2002, shih seksionin 'Burimet dhe informata plotësuese'.

<sup>5</sup> Grossman 2010



“ Për shkak se pajisjet elektronike shpejt dalin nga përdorimi dhe hidhen, dhe janë të vështira për t’u ripërdorur dhe për t’u recikluar, e-mbeturinat janë një nga burimet me rritje më të shpejtë të mbeturinave në botë. ”

Materialet bazë që përdoren në procesin prodhues, poashtu kanë ndikimet e tyre. Lëndët e para që shfrytëzohen në pajisjet elektronike kryesisht sigurohen nga minierat, të cilat kërkojnë sasi të madhe të tokës dhe të energjisë, dhe gjenerojnë shumë emetime të dëmshme. Për shembull, **për të prodhuar një ton ar, emetohen 10,000 tonë karbon dioksidi, palladium ose platin.**<sup>6</sup> Poashtu, shumë brengosëse janë edhe ndikimet në aspektin social që kanë të bëjnë me nxjerrjen e materialeve që përdoren në elektronikë.<sup>7</sup>

Pajisjet moderne elektronike shpejt dalin nga përdorimi dhe hidhen.<sup>8</sup> Ka pasur disa përpjekje për të bërë disa lloje të dizajneve që do ta bënë më të lehtë çmontimin ose përmirësimin e pasjisjeve, dhe konsumatorëve do t’u mundësonin ta zgjasin jetëgjatësinë e produkteve (shih Kutinë 2)<sup>9</sup>. Në fakt, shumë produkte janë më të lira për t’u zëvendësuar se sa për t’u rregulluar, edhe sikur të gjeni dikë që do ta rregullojë atë.

### Kutia 1. Gjysmëpërçuesit: Studimi i një rasti për ndërlikueshmërinë dhe kërkesat

Prodhimi i pajisjeve elektronike është një biznes që kërkon shumë materiale dhe energji. Për shembull, për prodhimin e gjysmëpërçuesve të vegjël (gjithashtu të njohur si mikroçipe apo qarqe të integruara) që përdoren në thuajse të gjitha pajisjet dhe që bënë revolucion në elektronikë, në aspekt të zbatimit dhe të funksionalitetit, nevojiten sasi shumë të mëdha të materialeve dhe të energjisë.

Përveç silikonit (ose ndonjë materiali tjetër) që përdoret për t’i bërë shtresat e tyre në formë të meshës (vaferit), përbërja kimike për prodhimin e këtyre komponenteve kyçe është shumë e madhe – **një prodhues i vetëm i gjysmëpërçuesve mund të përdorë prej 500 deri në 1000 kemikate të ndryshme**, kurse një analizë e vitit 2002 ka treguar se **prodhimi i një mikroçipi prej 2 gramësh gjeneron rreth 26 kg mbeturina**, disa prej të cilave janë shumë toksike.

Burimi: Grossman 2006: 59, fn 8

Ashtu siç zhvillimi teknologjik mund t’i bëjë produktet të vjetëruara, poashtu edhe marketingu agresiv i kompanive elektronike bën që, pajisjet që punojnë, të bëhen të vjetëruara pas vetëm një ose dy vitesh përdorimi. Kjo rezulton me cikle artificialisht të shpejta të zëvendësimit.<sup>10</sup>

<sup>6</sup> Schulep dhe të tjerët 2009

<sup>7</sup> Ngrija e shpresës për Kongon (Raise Hope for Congo) 2010

<sup>8</sup> ETBC 2009

<sup>9</sup> Grossman 2010

<sup>10</sup> UNEP 2005




Kur këto mallra të mos jenë më të nevojshme, do të ballafaqohemi me një problem të madh të mbeturinave. Përderisa shfrytëzimi i kompjuterëve dhe i pajisjeve elektronike po rritet vazhdimisht në të gjitha pjesët e botës, kjo nuk përcillet me rritje adekuate të infrastrukturës së nevojshme për t'i menaxhuar këto pajisje në mënyrë të sigurt në fund të jetës së tyre.<sup>14</sup>

Prodhuesit kanë shumë pak motivim që të dizajnonë produkte me jetë të gjatë, edhe pse mu këto biznese janë më kompetente për t'u marrë me këtë çështje. Si rezultat, shohim prodhim të tepërt të produkteve të dizajnuara për deponë digjitale, në kurriz të shëndetit të njeriut dhe të mjedisit.<sup>15</sup>

## Problemi #2: Produktet toksike bëhen mbeturina toksike

Prapa shkëlqimit të inovacioneve elektronike, qëndron një histori e errët, shpesh e injoruar nga prodhuesit dhe shitësit e këtyre mallrave.



**Figura 2.** Disa nga materialet e rrezikshme për shëndetin, që i përmbajnë pajisjet elektronike.

<sup>14</sup> Williams dhe të tjerët 2008: 6452

<sup>15</sup> Leonard 2010

**Mbi 1,000 materiale shfrytëzohen për t'i prodhuar pajisjet tona elektronike** dhe komponentet e tyre – çipat gjysmëpërçues, qarqet, disqet (disk drives), e kështu me radhë. **Shumë prej tyre janë toksike**, duke i përfshirë tretësit me klor, materialet zjarrduruese me brom, PVC, metale të rënda (siç janë plumbi, zhiva, arseni, kadmiumi dhe kromi gjashtëvalent), plastika dhe gazërat. Nëse nëse nuk menaxhohen me kujdes, këto janë të dëmshme për shëndetin e njeriut (Figura 2) dhe për mjedisin.<sup>16</sup>

“**Janë përdorur 1,450 tonë material zjarrdurues me brom, i quajtur TBBPA, për të prodhuar 991 milionë celularë që janë shitur në vitin 2006. Këtij kemikati i përshkruhet veprim neurotoksik**”

Greenpeace 2008a

**Edhe pse është e rrezikshme, hedhja në deponi është njëra nga metodat më të shpeshta të largimit të e-mbeturinave.** Të gjitha deponitë kullojnë në një masë të caktuar, që do të thotë se metale të rënda dhe materialet e tjera toksike të e-mbeturinave mund të kullojnë dhe ta ndotin tokën dhe ujin. **Rreth 40% të metaleve të rënda që hasen në deponitë në SHBA, duke përfshirë plumbin, zhivën dhe kadmiumin, vijnë prej e-mbeturinave.**<sup>17</sup> Deponitë poashtu mund ta ndotin atmosferën me emetime toksike të zhivës dhe me tymin nga zjarret e pakontrolluara.<sup>18</sup> Materialet toksike që përdoren në elektronikë e vështirësojnë reciklimin e tyre të sigurt. Për shembull, plumbi në monitorët televiziv CRT dhe llambat me zhivë në ekranet LCD (Kutia 3), si dhe materialet PVC, zjarrduruese, dhe shtojcat e tjera në komponentet plastike, së pari duhet të largohen e pastaj të bëhet reciklimi.<sup>19</sup> Duke mos marrë parasysh fakti se çka do të ndodhë me prodhimet pas daljes së tyre nga përdorimi, pajisjet elektronike prodhohen në atë mënyrë që, kur reciklohen, prodhojnë mbeturina dhe emetime ndotëse që i dëmtojnë njerëzit dhe planetin, veçanërisht kur përdoren teknika joadekuate për trajtim të e-mbeturinave.

### **Kutia 3. Ç'ka në TV? Disa rreziqe në ekranin tuaj**

Në televizorët tuaj ka materie toksike, që mund të shkaktojnë ndotje serioze, në qoftë se televizorin tuaj të vjetër e dërgoni në deponi. Televizorët e vjetër me gyp katodik (CRT), përmbajnë prej dy deri në katër kilogramë plumb, që mund të lirojë kemikate toksike kur të shkatërrohen në deponi, duke i ndotur ujërat nëntokësorë.

Televizorët e rinj LCD që kanë filluar të dominojnë në treg, përmbajnë llamba me zhivë për ta ndriçuar ekranin e tyre. Çdo televizor LCD shfrytëzon vetëm disa miligramë zhivë. Megjithatë, ky metal është aq toksik sa që edhe vetëm një gram zhivë, e bartur nëpërmjet ajrit çdo vit deri te një liqen prej 80 metrash, është e mjaftueshme që ta mbajë ujin e liqenit të kontaminuar në atë nivel, që peshqit e atij liqeni të mos jenë të sigurt për t'u ngrënë.

Burimi: ETBC 2009

Sikur prodhuesit të kishin pranuar të bëjnë dizajn më të sigurt me të cilin eliminohen përmbajtjet toksike, rreziqet nga dalja prej përdorimit e pajisjeve tona elektronike, do të zvogëloheshin dukshëm.

“**Vlerësohet se 22% e harxhimeve vjetore botërore të zhivës përdoren për pajisjet elektrike dhe elektronike**”

<sup>16</sup> Widmer dhe të tjerët 2005 dhe ETBC 2009

<sup>17</sup> ETBC 2009

<sup>18</sup> Empa 2009

<sup>19</sup> ETBC 2009

## Problemi #3: Pajisjet elektronike përmbajnë materiale të çmueshme dhe të rralla

Përveç që përmbajnë shumë substanca të dëmshme dhe toksike, pajisjet elektronike poashtu përmbajnë edhe substanca që janë shumë të çmueshme. Pjesa më e madhe e substancave të çmueshme gjenden te qarqet e shtypura të bordit (printed circuit board), të cilat i lidhin dhe i përkrahin komponentet elektronike.



**Figura 3.** E-mbeturinat përmbajnë shumë materiale të çmueshme dhe të rralla.

“**Më tepër ar mund të nxirret prej një toni metrik të bordeve të përdorura të qarqut se sa prej 17 tonëve metrikë të xeheve të arit’**”

Grossman 2010: 4

Në një kompjuter, kjo përfshin hekurin, aluminin, bakrin, plumbin, nikelin, kallajin, arin, argjendin, platinin dhe palladiumin. Metalet dhe materialet e tjera të çmueshme ekzistojnë në komponente të tjera elektronike, siç është bakri te telat, dhe hekuri dhe alumini te shtëpiza.<sup>20</sup> Shumë materiale që janë me rëndësi të madhe për prodhimin e pajisjeve të TKI, janë jashtëzakonisht të rralla. **Sasitë e 14 mineraleve që përdoren në elektronikën moderne janë në nivel kritik, kurse pritet që kërkesa për këto materiale të trefishohet deri në vitin 2030.**<sup>21</sup>

Disa prej tyre, siç janë tantalit, volframi dhe metalet e rralla, gjithashtu vijnë nga burime shumë të pasigurta, duke i përfshirë edhe vendet ku aktivitetet e kompanive që i nxjerrin ato, janë subjekt i brengosjes serioze dhe i fushatave nga ana e OJQ-ve për të drejtat e njeriut.<sup>22</sup> Duke i pasur parasysh pasojat që ndërliken me përfitimin e këtyre materialeve, si dhe faktin se disa prej tyre janë shumë të rralla, është me të vërtetë dëm i madh që ato të hidhen kur i çojmë makinat tona të vjetra në deponi ose në vende për reciklim jokualitativ. Duhet të kërkojmë nga prodhuesit që ta minimizojnë sasinë e lëndëve të para që përdoren në prodhimtari dhe t'i bëjnë pajisjet elektronike më të lehta për përdorim dhe për reciklim. Gjithashtu, duhet të përkujdesemi që e-mbeturinat të ngelin jashtë deponive, dhe një pjesë e resurseve, apo të gjitha resurset nga pajisjet tona elektronike të shfrytëzohen përsëri.

## Problemi #4: Menaxhimi i keq i e-mbeturinave u kushton njerëzve dhe planetit

E-mbeturinat vështirë reciklohen sepse përmbajnë komponente të rrezikshme të cilat kërkojnë aftësi të veçanta për t'i trajtuar. Një numër i madh i pajisjeve elektronike që nuk na nevojiten më, përfundojnë në deponi ose furra për djegie të mbeturinave, së bashku me mbeturinat e tjera komunale, ose largohen në ndonjë mënyrë tjetër.

<sup>20</sup> Për më tepër informata për materialet e çmueshme në pajisjet elektronike, shih [www.ewasteguide.info](http://www.ewasteguide.info)

<sup>21</sup> Komisioni Evropian (European Commission) 2010

<sup>22</sup> Projekti "Mjaff" (Enough Project) 2011

**Është shokues fakti se, nga 50 milionë tonë e-mbeturina që janë gjeneruar në vitin 2009, vetëm 13% është recikluar.**<sup>23</sup> Kjo është një hedhje e tmerrshme e resurseve të vlefshme, veçanërisht kur merren parasysh pasojat nga nxjerrja e lëndëve të para, që janë të shoqëruara me prodhimin e pajisjeve elektronike. Sikur kjo të bëhet në mënyrë të sigurt dhe të drejtë, për “gërmimin” nëpër aparatet tona të vjetra për të përfituar materiale prej tyre, nevojitet vetëm një pjesë e energjisë që nevojitet për “gërmim” të xeheve në natyrë.<sup>24</sup> Gjithashtu, duke pasur parasysh natyrën e rrezikshme të disa materialeve të pajisjeve elektronike, menaxhimi i keq me e-mbeturinat, në shumë vende do të thotë se komunitetet dhe mjedisi e paguajnë çmimin për dizajnin toksik dhe joefikas të prodhuesve.

Hedhja në deponi apo djegia në furrat për djegie të mbeturinave nuk janë opcionet e vetme të këqija se si përfudojnë pajisjet tona elektronike. Shumë shpesh, pajisjet elektronike përfundojnë duke u trajtuar në mënyrë të keqe, joadekuate, edhe atë gjithnjë e më shumë në vendet në zhvillim, ku, zakonisht në mënyrë joligjore, eksportohen e-mbeturinat e vendeve të zhvilluara. Për shkak të përmbajtjes toksike të pajisjeve elektronike, metodat e vjetëruara për nxjerrje të lëndëve të para paraqesin rrezik të madh për shëndetin e punëtorëve – një pjesë e të cilëve janë fëmijë – si dhe për mjedisin. (Kutia 4).

#### **Kutia 4. Eksporti i mbeturinave toksike: reciklimi joformal në Guiju, Kinë.**

Guiju, Kinë. Punëtorët, shpesh fëmijë të vegjël, gërmojnë me duar të zhveshura nëpër grumbuj të pajisjeve elektronike, duke përdorur çekiçë dhe dalta, për t'i shkatërruar monitorët dhe për t'i çmontuar pajisjet që t'i nxjerrin pajisjet e vlefshme. Pjesa më e rrezikshme dhe më e dëmshme për mjedisin e procesit të “reciklimit” është rikthimi i materialeve që gjenden në qarqet e bordit, të cilat ngrohen në një përzierje të lëngshme për kallaisje që përbëhet nga plumbi dhe kallaji, derisa çipat të mund të hiqen. Ekspozimi i përditshëm në tymin që del gjatë kallaisjes është jashtëzakonisht i dëmshëm.

Nxjerrja e metaleve të çmueshme zakonisht bëhet me djegie të hapur. Në rajonin Guiju, është formuar një fshat joformal në vendin ku digjen telat për ta nxjerrë bakrin, derisa hiri toksik dhe mbeturinat e mbulojnë pjesën ku njerëzit jetojnë dhe gatuajnë, kurse fëmijët luajnë. Këto procese joformale të reciklimit jo vetëm që paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për njerëzit që punojnë aty, por ato, poashtu janë edhe rrezik i madh ekologjik për tërë komunitetin. Për shembull, djegia e hapur dhe hudhja e pjesëve të pavlefshme në ujë, e ka kontaminuar ujin në Guiju.

Burimi: Puckett dhe Smith, 2002

Duke pasur parasysh se e-mbeturinat përmbajnë shumë materiale të çmueshme, eksporti joligjor është i motivuar nga profiti. E-mbeturinat shkojnë në vende ku rregullativa shëndetësore dhe e sigurisë për punëtorët dhe mjedisin është në nivel të ulët (prandaj edhe harxhimet e punëtorëve janë të vogla).<sup>25</sup> Në këto raste, mundësitë për maksimalizimin e profitit nga reciklimi i e-mbeturinave janë maksimale; por në kurriz të njerëzve dhe të planetit. Për shembull, plumbi që është shumë toksik për njerëzit dhe mjedisin, mirëpo gjendet në sasi të mëdha te monitorët dhe televizorët CRT, si dhe te pjesët e salduara dhe te bordet e qarkut te kompjuterët dhe celularët më të vjetër, është i ndaluar në deponitë e shumë vendeve.

<sup>23</sup> ABI in BBC 2010

<sup>24</sup> Schulep et al 2009: 6

<sup>25</sup> Puckett i Smith 2002

Mirëpo, edhe përkundër kësaj, monitorët dhe televizorët CRT dhe celularët e vjetër, për reciklimin e sigurt të të cilëve nevojiten teknika të veçanta, në vende si Kina, akoma hidhen në deponi dhe çmontohen me dorë.<sup>26</sup> Bile edhe në BE, ku ndoshta ekziston regjimi më rigoroz rregullator në botë për pajisjet e vjetëruara, vetëm një e treta e e-mbeturinave trajtohet në përputhje me kërkesat e Direktivës për MPEE. Pjesa tjetër, ose përfundon në deponi, ose trajtohet në mënyrë jokualitative, qoftë brenda ose jashtë BE-së.<sup>27</sup> Këtu bën pjesë edhe eksporti joligjor në vendet në zhvillim, ku recikluesit joformalë i përpunojnë mbeturinat në mënyrë jo të sigurt, duke e rrezikuar shëndetin e tyre dhe duke e ndotur ambientin.<sup>28</sup>



**Figura 4.** Disa nga rrugët e tregtisë globale me e-mbeturina.

Nën këto kushte, vendet në zhvillim vuajnë në mënyrë të zhdrejtë nga bara e problemit të e-mbeturinave, edhe përkundër ekzistimit të mekanizmave globalë që përpiqen ta trajtojnë këtë lloj të tregtisë toksike. Në vitin 1989 u soll Konventa e Bazelit për kontrollimin e qarkullimit ndërkuftar të mbeturinave të rrezikshme dhe hedhjen e tyre, me qëllim që të kufizohet tregtia jo e drejtë me mbeturina toksike. Në vitin 1994, me Konventën e Bazelit u arrit marrëveshje për ndalim të plotë të eksportit të mbeturinave të rrezikshme nga vendet e OECD-së në vendet që nuk janë anëtare të OECD-së, **duke i përfshirë edhe ato mbeturina që janë për reciklim.**

Edhe përkundër ndalesës së Bazelit, mijëra tonë e-mbeturina çdo vit përfundojnë në vendet në zhvillim. Arsyeja pjesërisht qëndron në atë se njëri nga eksportuesit më të mëdhenj – SHBA-të, ende nuk e kanë nënshkruar ndalesën. Vlerësohet se 50 deri në 80 përqind të e-mbeturinave të mbledhura në SHBA nuk reciklohen atje, por eksportohen jashtë saj.<sup>29</sup> Gjithashtu, për shkak të zbatimit të dobët të Konventës dhe të ndalesës në nivel global, kjo tregti toksike vazhdon, ndërsa komunitetet e varfëra vazhdojnë të vuajnë nga dizajni toksik dhe joefikas.

<sup>26</sup> Greenpeace 2005

<sup>27</sup> Komisioni Evropian 2008

<sup>28</sup> BBC 2010

<sup>29</sup> Puckett dhe Smith 2002



## Cila është zgjidhja? Si të minimizohen ndikimet e pajisjeve elektronike dhe të e-mbeturinave

**Zgjidhja:** Prodhuesit duhet të mbajnë përgjegjësi për mallrat e tyre gjatë tërë ciklit të tyre jetësor, ashtu që të mund të dizajnojnë prodhime më të mira që zgjasin dhe që nuk do të jenë të dëmshme në fund të jetës së tyre.

### Prodhuesit duhet:

1. Të bëjnë produkte më të pastra
2. Të bëjnë produkte më afatgjata
3. T'i marrin prapa produktet e tyre për ripërdorim dhe reciklim të sigurt

Harxhimet reale të teknologjisë i përfshijnë edhe ndikimet sociale dhe ekologjike gjatë tërë ciklit të saj jetësor. Trendet aktuale në prodhimin dhe konsumimin e pajisjeve elektronike, së bashku me mungesën e opsioneve për menaxhim të sigurt të e-mbeturinave në shumë vende, do të thotë se edhe njerëzit edhe planeti e paguajnë çmimin për dizajnin toksik dhe joefikas. Situata aktuale është jo e drejtë, por njëkohësisht edhe e paqëndrueshme.

Shumë debate mediatike dhe politike fokusohen në atë se si mund të zvogëlohet ndikimi ekologjik i pajisjeve elektronike duke e përmirësuar efikasitetin e tyre energjetik. Edhe pse kjo është e rëndësishme, megjithatë mund t'i vë në plan të dytë pjesët e tjera, edhe më të dëmshme, nga cikli jetësor i produktit, si për shembull kur përgatiten produktet dhe pasi të bëhen mbeturina. Për shembull, pajisjet elektronike siç janë televizorët dhe kompjuterët janë përplot me mikroçipe të uritur për energji dhe materiale (Kutia 1). Kjo e bën fazën e tyre të prodhimit jashtëzakonisht të rëndësishme. **Te kompjuterët, madje 80 përqind e ndikimit mbi mjedisin jetësor, mund të ketë ndodhur, bile edhe para se ai të ndizet për herë të parë.** Domethënë, duke u fokusuar në efikasitetin energjetik, në fakt e trajtojmë vetëm 20 përqind të problemit.<sup>30</sup> Sidoqoftë, përmirësimet sa i përket efikasitetit energjetik mund të zhbëhen me faktin se konsumojmë gjithnjë e më shumë sende.<sup>31</sup>

Filozofia e udhëheqjes së biznesit nga ana e kompanive elektronike është se blerja e aparateve të reja është shumë më e lehtë se sa rregullimi i të vjetrave, dhe kjo është shumë më atraktive se sa rritja e jetëgjatësisë së aparateve funksionale.

“ Çdo përpjekje serioze për minimizimin e ndikimit të pajisjeve elektronike duhet ta shqyrtojë tërë ciklin jetësor, duke e përfshirë kohën e prodhimit dhe atë pas daljes nga përdorimi. ”

Në këtë rast, që t'i bëjmë ekologjike pajisjet elektronike, duhet të shohim më larg se sa vetëm te efikasiteti i energjisë gjatë kohës së përdorimit. **Duhet të fokusohemi te prodhimtaria**, të gjejmë mënyra ta minimizojmë shfrytëzimin e materialeve dhe të energjisë, si dhe ta zvogëlojmë prodhimtarinë e panevojshme. **Poashtu, duhet të fokusohemi edhe në atë se çka ndodh me pajisjet elektronike pas daljes së tyre nga përdorimi**, me qëllim që t'i shmangemi

<sup>30</sup> Williams 2003 dhe Williams 2004

<sup>31</sup> Në EEB atë e quajnë "efekti i kërcimit" ('rebound effect'), shih. EEB, 2009



ndotjes dhe shkatërrimit të resurseve natyrore, që ndodh për shkak të menaxhimit joadekuat me mbeturinat. Mirëpo, edhe reciklimi dhe trajtimi i sigurt i e-mbeturinave kanë çmimin e tyre. Përbërja e ndërlikuar dhe e rrezikshme e pajisjeve elektronike moderne e bën reciklimin e tyre sfidues dhe të shtrenjtë.<sup>32</sup> Për reciklim të sigurt nevojitet sistem që do t'i ndajë e-mbeturinat nga mbeturinat e tjera. Në një sistem të tillë, e-mbeturinat nuk do të hidheshin në deponi, por do të përfundonin në duart e recikluesve me reputacion. Dhe dikush duhet ta paguajë dhe ta koordinojë këtë. Për momentin, komunitetet e bartin barën e ballafaqimit me e-mbeturinat. Ato pësojnë ekonomikisht (nëpërmjet tatimeve të rritura të cilat autoritetet i shfrytëzojnë për të vendosur dhe për të menaxhuar sisteme për e-mbeturina) ose me shëndetin e tyre dhe me ambientin e ndotur, kur e-mbeturinat trajtohen në mënyrë të papërgjegjshme. Vendosja e sistemeve për reciklim të sigurtë të e-mbeturinave tona është një pjesë e mozaikut. Mirëpo, vetvetiu, kjo asnjëherë nuk do të mjaftojë që të minimizohet ndikimi i pajisjeve elektronike, veçanërisht nëse vazhdojmë të gjenerojmë mbeturina të panevojshme. Për t'i menaxhuar ndikimet e pajisjeve elektronike, poashtu, së pari duhet gjetur mënyra për ta zvogëluar sasinë e mbeturinave dhe të materieve toksike në to. Një mënyrë për ta bërë këtë, është të fokusohet vëmendja te burimi i problemit: te dizajni dhe te prodhimitaria. Prodhuesit e pajisjeve elektronike janë burimi i problemit, mirëpo ato poashtu mund të jenë edhe zgjidhja: duke marrë përgjegjësi për mallrat e tyre gjatë tërë ciklit të tyre jetësor – nga prodhimi e deri te fundi i jetës së tyre.<sup>33</sup>

## Aktivitete për prodhuesit

Për të penguar ndonjë krizë me e-mbeturinat dhe për ta mbrojtur mjedisin jetësor dhe shëndetin e të gjithë njerëzve të përfshirë në zinxhirin e produkteve elektronike, prodhuesit e pajisjeve elektronike, produkteve të tyre duhet t'u bëjnë tri gjëra: ***t'i bëjnë më të pastra, t'i bëjnë më afatgjata dhe t'i marrin prapa.***<sup>34</sup>

### 1. T'i bëjnë më të pastra

Prodhuesit e pajisjeve elektronike duhet të dizajnojnë produkte më të mira, të cilat janë të sigurta dhe të lehta për reciklim, që nuk do të jenë të rrezikshme pas përfundimit të jetës së tyre, dhe për prodhimin e të cilave nevojiten më pak lëndë të para dhe më pak energji. Kjo do të thotë se ata duhet të dizajnojnë pa materie toksike<sup>35</sup> dhe të dizajnojnë me më pak materiale dhe komponente në përgjithësi, dhe me më shumë materiale të ricikluara dhe pjesë të ripërdorura.

### 2. T'i bëjnë më afatgjata

Prodhuesit e pajisjeve elektronike duhet të dizajnojnë dhe të promovojnë prodhime me afat më të gjatë jetësor. Kjo do të thotë, të dizajnohen prodhime të cilat lehtë përmirësohen dhe riparohen, dhe të cilat lehtë mund të çmontohen për zëvendësim dhe ripërdorim të komponenteve, si dhe për reciklim të prodhimeve, pas daljes së tyre nga përdorimi. Kjo do të thotë edhe informim i recikluesve dhe i riparuesve për materialet e rrezikshme në prodhimet e tyre dhe për teknikat adekuate për menaxhimin me to. Kjo, gjithashtu, do të thotë që konsumatorët të informohen dhe t'u ofrohen opsione për zgjatjen

<sup>32</sup> Greenpeace 2008a

<sup>33</sup> Greenpeace 2008b

<sup>34</sup> Për më tepër informata, shih ETBC dhe projektin Story of Stuff: <http://www.storyofstuff.com/electronics/>

<sup>35</sup> Në shumë raste, tashmë ekzistojnë alternative më të sigurta: Greenpeace 2008b.

e afatit jetësor të produkteve të tyre, siç janë detajet për shërbimet për riparim dhe përmirësim, si dhe lokacione për ripërdorimin e makinave të padëshiruara.

### 3. T'i marrin prapa

Komunitetet nuk duhet t'i bartin pasojat mbi mjedisin jetësor dhe shëndetin për shkak të menaxhimit të keq me e-mbeturinat, e poashtu edhe të obliguarit tatimorë nuk duhet ta paguajnë çmimin për reciklimin e pajisjeve të vjetra elektronike. Prodhuesit e pajisjeve elektronike duhet të mbajnë përgjegjësi për prodhimet e tyre gjatë tërë ciklit të tyre jetësor, dhe posa prodhimet e tyre të vijnë në fund të jetës së tyre të dobishme, t'i marrin prapë për ripërdorim dhe reciklim të sigurt. Kjo do të thotë se e-mbeturinat duhet t'u nënshtrohen standardeve shumë të larta për trajtim (për shembull, e-mbeturinat të mos hidhen në deponi, të mos priten e as të mos digjen, por vetëm të reciklohen me kualitet të lartë etj.) dhe nuk bën të hidhen në deponi, as brenda shtetit, e as në shtete të huaja.

#### Pse prodhuesit duhet të mbajnë përgjegjësi?

Jeta e pajisjeve elektronike përbëhet nga nxjerrja e lëndëve të para, transporti, dizajnimi dhe prodhimi i produktit, shitja me pakicë dhe distribuimi, përdorimi, ripërdorimi dhe në fund, trajtimi pas daljes nga përdorimi. Këtu bëjnë pjesë minatorët, prodhuesit, shitësit, konsumatorët, komonat, recikluesit dhe të tjerët. Të gjithë këta aktorë mund të ndikojnë mbi llojet e ndikimeve që pajisjet elektronike i kanë mbi njerëzit dhe planetin. Megjithatë, mënyra më e mirë që të bëjmë pajisje elektronike me ndikim sa më të vogël negativ, është të kihen për qëllim aktorët më të rëndësishëm dhe atyre t'u jepen përgjegjësi të qarta.<sup>36</sup> Janë prodhuesit, ata që përfitojnë nga pajisjet elektronike që bëhen mbeturina, pjesërisht për shkak se komunitetet e paguajnë çmimin për dëmtimin e mjedisit jetësor dhe të shëndetit nga prodhimet e tyre. Gjithashtu, janë prodhuesit, ata që mund të bëjnë ndryshime te produktet që në fillim, sepse i kanë njohuritë më të mëdha teknike për produktet e tyre dhe mund të ndikojnë te dizajni dhe prodhimi i tyre.<sup>37</sup> Janë prodhuesit, ata që mund të zgjedhin t'i largojnë materiet toksike, ta minimizojnë përdorimin e lëndëve të para, ta pengojnë prodhimin joefikas, ta rrisin potencialin për ripërdorim dhe reciklim etj.<sup>38</sup> Targetimi i prodhuesve, si aktorë kryesorë në procesin e minimizimit të ndikimit negativ të pajisjeve elektronike dhe të e-mbeturinave, bazohet në parimin e **përgjegjësisë së zmadhuar të prodhuesit (PZP)**.

#### Kutia 5. Pse qasja PZP është e përshtatshme për pajisjet elektronike?

Përgjegjësia e zmadhuar e prodhuesit (PZP) po pranohet me të madhe në strategjitë për menaxhim me mbeturinat nëpër botë, posaçërisht për produktet që kërkojnë trajtim të veçantë në fund të jetës së tyre për shkak të përmbajtjes së tyre të rrezikshme. Për këtë arsye, qasja PZP është e përshtatshme për menaxhimin me e-mbeturinat. Sasitë gjithnjë e më të mëdha të e-mbeturinave toksike dhe vështirësitë për reciklimin e tyre, na e bëjnë me dije se problemin duhet ta shohim te zanafilla – te dizajni dhe prodhimi. PZP është një zgjidhje e pranuar që është e përshtatshme për minimizimin e ndikimit të pajisjeve elektronike, veçanërisht kur ato bëhen mbeturina (shih fushatat e Koalicionit për rikthimin e pajisjeve elektronike (ETBC) dhe të Greenpeace-it). Poashtu, prodhimi i pajisjeve elektronike është një proces që kërkon shumë material dhe energji. Për shembull, për prodhimin e çdo kompjuteri nevojiten 22 kilogramë kemikate toksike, 240 kilogramë lëndë djegëse fosile dhe 1.500 kilogramë ujë.<sup>1</sup> Secila strategji për zvogëlimin e ndikimit të TKI-së, patjetër duhet të përqëndrohet te prodhimi. Qasja PZP e mundëson një gjë të tillë.

Burimi: Williams 2003

<sup>36</sup> EEB 2010: 14

<sup>37</sup> EEB 2010: 14

<sup>38</sup> IIIEE 2006a: 1

Me të, kërkohet nga prodhuesit e pajisjeve elektronike që të marrin përgjegjësi për tërë ciklin jetësor të produkteve, duke e përfshirë edhe kohën kur ato bëhen mbeturina. PZP është një qasje e dobishme për ta minimizuar ndikimin negativ të pajisjeve elektronike dhe të e-mbeturinave (shih Kutinë 5) sepse me të:

- **zhvendoset ngarkesa financiare dhe ekologjike për trajtimin e e-mbeturinave prej komuniteteve të prodhuesit**, dhe fillohet me përfshirjen e harxhimeve reale të teknologjisë në çmimin e produktit.

- **mund të stimulohet ekodizajni**,<sup>39</sup> me atë që prodhuesve do t'u ofrohen subvencione financiare, që prodhimet e tyre t'i dizajnojnë në atë mënyrë që do të zvogëlohen ndikimet e tyre negative mbi mjedisin jetësor gjatë tërë ciklit jetësor të produktit. Për shembull, nëse prodhuesit duhet ta paguajnë menaxhimin e produkteve të tyre pas daljes së tyre nga përdorimi, atëherë ata duhet t'i dizajnojnë ato në mënyrë që do ta zvogëlonte këtë harxhim, si për shembull, duke i larguar komponentet e rrezikshme dhe duke i bërë ato më të lehta për ripërdorim dhe reciklim.<sup>40</sup>

Pas më shumë se një dekade të sjelljes së vendimit në mënyrë të kujdesshme, prodhuesit dhe qeveritë në BE, e pranuan konceptin e përgjegjesisë së prodhuesit, si mekanizmin më të mirë dhe më të drejtë për t'u ballafaquar me problemin e e-mbeturinave në Evropë. Kjo është reflektuar edhe në Direktivat MPEE dhe NPMR.<sup>41</sup> Ato janë implementuar në mbi 20 vende anëtare të BE-së. Së bashku me aktet ligjore të dizajnuara për ta zvogëluar përdorimin e energjisë dhe ndikimet e tjera,<sup>42</sup> këto Direktiva i kanë për qëllim ndikimet e ndryshme negative të pajisjeve elektronike gjatë jetës së tyre, dhe të gjithë theksojnë se nëpërmjet ekodizajnit, prodhuesi është në pozitë më të mirë për t'i trajtuar ato.<sup>43</sup>

## Aktivitetet për palët e tjera

### Që të minimizohet ndikimi i elektronikës dhe i e-mbeturnave:

#### Qeveritë duhet:

1. Ta ndalojnë importin dhe eksportin e e-mbeturinave
2. Ta ndalojnë hudhjen e e-mbeturinave në deponi – të promovojnë ripërdorimin e pajisjeve dhe ta bëjnë të obligueshëm reciklimin e e-mbeturinave
3. Të sjellin ligj për përgjegjësinë e prodhuesit dhe ta promovojnë ekodizajnin
4. T'i mbikëqyrin aktorët dhe t'i dënojnë veprat penale

#### Konsumatorët duhet:

1. Të blejnë më pak, dhe të blejnë në mënyrë ekologjike
2. T'i kthejnë mallrat e tyre prapa te prodhuesit për ripërdorim dhe reciklim të sigurtë

Çdo qasje për ta minimizuar ndikimin negativ të pajisjeve elektronike dhe të e-mbeturinave, kërkon që prodhuesit ta marrin përgjegjësinë kryesore. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se të tjerët nuk duhet të luajnë asnjë rol. Për shembull, qeveritë duhet të sigurojnë politika dhe ligje të drejta me të cilat do të nxitet ekodizajni dhe do të sigurohet respektimi i të drejtave.

<sup>39</sup> Ekodizajni paraqet integrimin e aspekteve ekologjike në dizajnin e produkteve me qëllim të përmirësimit të performancave ekologjike të produkteve gjatë tërë ciklit jetësor.

<sup>40</sup> IIEE 2006a

<sup>41</sup> Direktiva 2002/96/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës, e datës 27 janar 2003, për mbeturinat e pajisjeve elektronike dhe elektronike (MPEE) dhe Direktiva 2002/95/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës, e datës 27 janar 2003 për ndalimin e përdorimit të disa substancave të rrezikshme të pajisjet elektrike dhe elektronike.

<sup>42</sup> Direktiva 2009/125/KE për përcaktimin e kornizës për vendosjen e kushteve për ekodizajn për prodhimet që shfrytëzojnë energji (Direktiva EuP).

<sup>43</sup> Për një pasqyrë të këtyre tri instrumenteve, shih EEB 2010.

Gjithashtu, që të minimizohet ndikimi negativ i pajisjeve elektronike dhe i e-mbeturinave, duhet të trajtohet edhe çështja e shprehive për konsumim dhe hedhje të pajisjeve nga ana e konsumatorëve, që do të thotë se konsumatorët kanë rol kyç.<sup>44</sup>

## Aktivitetet për qeveritë

Qeveritë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e politikave dhe në rregullimin e shprehive, me qëllim që të nxisin praktika të mira që kanë të bëjnë me pajisjet elektronike dhe e-mbeturinat. Prandaj, nga qeveritë duhet t'i kërkojmë këto gjëra:

### 1. Të mos lejojnë që e-mbeturinat të hyjnë brenda – ose të dalin jashtë.

Të domosdoshme janë ndalesat për import dhe eksport të e-mbeturinave, me qëllim që të mbrohen komunitetet dhe mjedisi jetësor në vendet pa infrastrukturë të sigurt për menaxhim me e-mbeturinat. Ato, poashtu, janë të nevojshme që t'u mundësohet të gjitha vendeve t'i ndërtojnë dhe t'i mbajnë kapacitetet e tyre për menaxhim me e-mbeturinat e tyre. Mbeturinat e eksportuara paraqesin humbje të resurseve të vlefshme për industrinë recikluese në vendin e eksportit, ndërsa mbeturinat e importuara mund t'i stërngarkojnë sistemet për menaxhim me mbeturinat të vendeve importuese.<sup>45</sup> Gjithashtu, eksporti i e-mbeturinave e ngulfat inovacionin që nevojitet për trajtim të problemit që në filllet e tij – gjatë dizajnit dhe prodhimit të tij. Nëqoftëse prodhuesit, nëpërmjet eksportit mund t'i bartin harxhimet që janë si rezultat i dizajnit toksik dhe joefikas, në vende të treta të cilat janë më pak të afta për t'u ballafaquar me të, atëherë ato mund t'i vonojnë përpjekjet e tyre për të bërë produkte më pak të dëmshme që në fillim.<sup>46</sup> Prandaj, **qeveritë duhet ta ndalojnë importin dhe eksportin e e-mbeturinave. Ato vende që tashmë kanë ndalesa të tilla, duhet t'i zbatojnë ato.**<sup>47</sup>

### 2. Të mos lejojnë që e-mbeturinat të shkojnë në deponi

E-mbeturinat e hedhura në deponi, ose në ndonjë lokacion tjetër, jo vetëm që janë vdekjeprurëse, por kjo paraqet edhe një mundësi të lëshuar. Materialet toksike tek e-mbeturinat mund ta ndotin tokën, ujin dhe ajrin, ndërsa kur pajisjet elektronike nuk ripërdoren ose nuk reciklohen, humben resurse të vlefshme. E-mbeturinat nuk duhet të hidhen në deponi (ose në vende të tjera joformale për hedhje të mbeturinave), ku mund të bëjnë dëme serioze.<sup>48</sup> Në vend të kësaj, duhet të dërgohen tek operatorët legjitimë për trajtimin e mbeturinave. Në qoftë se pajisja funksionon, ajo duhet të ripërdoret, ndërsa nëse nuk funksionon, ajo duhet të reciklohet. Poashtu, sikurse edhe te rasti i eksportit të e-mbeturinave, e-mbeturinat e hedhura në deponi, i ngulfatin mundësitë për inovacion, me atë që u lejon prodhuesve që harxhimet nga dizajni toksik dhe joefikas t'i bartin te komunitetet dhe planeti, në vend që të fillojnë të dizajnojnë produkte më të pastra dhe më ekologjike. Prandaj, **qeveritë duhet ta implementojnë ndalesën për hedhje të e-mbeturinave në deponi. Pajisjet funksionale duhet të ripërdoren; të gjitha e-mbeturinat duhet të reciklohen.**

<sup>44</sup> EEB 2009

<sup>45</sup> IIIEE 2006a

<sup>46</sup> Puckett dhe Smith 2002

<sup>47</sup> Shumë vende tashmë kanë instrumente ligjore me të cilat menaxhohet tregtia me menturina të rrezikshme. Për shmebull, me Rregullativën e BE-së për ngarkim të mbeturinave (Rregullativa (KE) Nr. 1013/2006) transponohet Konventa e Bazelit dhe ndalesa, në ligjin e BE-së, nëpërmjet kontrollit të qarkullimit ndërkufitar të mbeturinave të rrezikshme, dhe ndalesës për eksportin e tyre në vendet që nuk janë anëtare të OECD-së. Vetë fakti që eksporti vazhdon, tregon se problemi qëndron te implementimi.

<sup>48</sup> ETBC 2009

### 3. Të miratojnë korniza ligjore për përgjegjësi të prodhuesit, ta inkurajojnë ekodizajnin

Që t'u mundësojnë prodhuesve të pajisjeve elektronike të dizajnojnë produkte që janë të sigurta për njerëzit dhe planetin, dhe të cilat nuk shkaktojnë dëme pas daljes nga përdorimi, qeveritë duhet:

- **Të fusin në përdorim ndalesa për materie** që prodhuesit ta zvogëlojnë dhe eventualisht ta eliminojnë përdorimin e materialeve toksike në elektronikë. Gjithashtu, prodhuesit duhet të sigurojnë informata për materialet e rrezikshme në produktet e tyre dhe mënyrën adekuate me të cilën konsumatorët dhe recikluesit duhet të menaxhojnë me to.<sup>49</sup>

- **T'i bëjë prodhuesit të mbajnë përgjegjësi individuale për menaxhimin e produkteve të tyre pas daljes së tyre nga përdorimi.** Kjo do të thotë se ata duhet t'i mbulojnë të gjitha harxhimet për menaxhimin e produkteve të tyre pas daljes së tyre nga përdorimi, nga grumbullimi, nëpërmjet reciklimit e deri te largimi përfundimtar, t'u ofrohen subvencione për ekodizajn dhe të zhvillohen tregjet e brendshme për reciklim.<sup>50</sup> Që kjo të funksionojë, cilido qoftë program për përgjegjësi të prodhuesit duhet të përfshijë një numër të madh produktesh, e poashtu duhet t'i përfshijë edhe të gjithë prodhuesit që veprojnë në vend, e këtu bëjnë pjesë, prodhuesit, pronarët e brendeve dhe importuesit. Duhet të jetë e lirë dhe e lehtë për përdorim nga konsumatorët.<sup>51</sup>

- **Të implementojnë qëllime ambicioze për mbledhje dhe rikthim,** me qëllim që të mos lejohet që e-mbeturinat të përfundojnë në deponi dhe që prodhuesit të motivohen të zhvillojnë infrastrukturë adekuate dhe efektive për mbledhje, ripërdorim dhe reciklim.<sup>52</sup> Qëllimet duhet të rriten me kalimin e kohës, që prodhuesit vazhdimisht ta përmirësojnë dizajnin dhe menaxhimin e pajisjeve të tyre elektronike, pas daljes së tyre nga përdorimi.

- **Të implementohen standarde serioze dhe të zbatueshme për trajtimin e mbeturinave.** Që t'u jepet fund praktikave të dëmshme për trajtimin e mbeturinave (për shembull, hedhja në deponi, djegia nëpër furra dhe eksporti), dhe që të inkurajohet përmirësimi i vazhdueshëm i menaxhimit të e-mbeturinave, të gjithë operatorët për mbledhje dhe trajtim të mbeturinave duhet të jenë të licencuar dhe ta kenë kaluar inspeksionin e agjencisë përkatëse kombëtare për mjedis jetësor. Duhet të implementohen standarde serioze dhe të zbatueshme. Këtu bëjnë pjesë standardet minimale për trajtim të prodhimeve me të cilat bëhet tregti për ripërdorim (të pengohet tregtia e rrejtshme për e-mbeturina të ofruara si pajisje të përdorura elektronike) dhe kërkesat për largim të materialeve dhe të komponenteve të rrezikshme (për shembull, frigoriferë, bateri, drita të pasme me zhivë për vetura) para trajtimit të mëtutjeshëm.

- **Të edukojnë dhe të komunikojnë.** Të gjithë aktorët duhet ta dinë rolin dhe përgjegjësitë e tyre, që sistemi për menaxhim me e-mbeturinat të funksionojë në mënyrë adekuate. Qeveritë duhet të zhvillojnë fushata për ngritje të vetëdijes dhe për komunikim, me qëllim që të nxitet pjesëmarrje më e madhe, si dhe të sigurohet respektimi i ligjit dhe praktikave të mira në menaxhimin me e-mbeturinat. Qeveritë, poashtu, mund t'i edukojnë qytetarët për nevojën që të zvogëlohet konsumi i përgjithshëm, për shembull, duke e promovuar ripërdorimin e pajisjeve elektronike ose zëvendësimin e produkteve me shërbime (për shembull, huazim, ndarje, etj.), që të zvogëlohet sasia e mbeturinave në përgjithësi.<sup>53</sup>

49 GRRN/SVTC 2008

50 GRRN/SVTC 2008 dhe IIIIE 2006b

51 Greenpeace 2008b

52 GRRN/SVTC 2008

53 EEB 2009 dhe ACR 2003

#### 4. Ta zbatojnë ligjin

Në një sistem të sigurt dhe të drejtë për e-mbeturina, të gjithë aktorët i zbatojnë rregullat dhe nuk ka “voztije pa pagesë”,<sup>54</sup> eksport ilegal ose trajtim të keq. Për këtë, nevojiten mbikëqyrje dhe zbatim i ligjit me dënime të ashpra për ata që e thejnë atë,<sup>55</sup> Këtu hyjnë dënimet me të holla, por edhe dënime me burg për vepra më të rënda penale ndaj mjedisit. ***Qeveritë duhet t'u ofrojnë resurse të mjaftueshme trupave që janë përgjegjëse për mbikëqyrje efektive dhe kontrollim të sistemit.***

#### Aktivitetet për konsumatorët

Për shkak se janë ata që i sjellin vendimet për të blerë dhe për të hedhur, konsumatorët luajnë rol shumë të rëndësishëm në minimizimin e ndikimeve negative të pajisjeve elektronike dhe të e-mbeturinave. Ata duhet:

**1. Të blejnë më pak dhe të blejnë në mënyrë ekologjike.** Madje edhe me përmirësimet e mirëfillta në dizajnin e pajisjeve elektronike, në afat të gjatë nuk mund të shpresojmë t'i zvogëlojmë grumbujt gjithnjë e më të mëdhenj të e-mbeturinave, pa një zvogëlim të përgjithshëm të konsumimit.<sup>56</sup> Konsumatorët duhet ***të mendojnë dy herë se a u duhet me të vërtetë ndonjë aparat i ri, para se ta blejnë atë*** – a mund të zgjatet jeta e makinës së re, duke e përmirësuar apo duke e riparuar? Kur nevojiten aparate të reja, konsumatorët mund t'i japin një porosi të qartë industrisë për të prodhuar produkte me dizajn më të mirë dhe prodhimtari me përgjegjësi më të madhe, me atë që ***do të blejnë vetëm nga prodhuesit ekologjikë***.<sup>57</sup> Ekzistojnë rang-lista me performansa të mira dhe të këqija ekologjike (shiko Udhëzuesin e GreenPeace-it për pajisjet elektronike më ekologjike).

**2. T'i kthejnë prapa.** Që të sigurohet se prodhuesit do ta përfshijnë harxhimin e vërtetë të teknologjisë në produktet e tyre, konsumatorët nuk duhet të lejojnë që produktet e tyre të përfundojnë në deponi ose të dërgohen diku tjetër për trajtim të keq. Kur mallrat nuk u duhen më, konsumatorët duhet:

**- Nëse funksionojnë, t'i vënë në dispozicion për ripërdorim.** Duke u dhënë shtëpi të dytë pajisjeve të padëshirura elektronike arrijmë përfitime të mëdha për mjedisin jetësor dhe shoqërinë. Për shembull, ripërdorimi i kompjuterëve që punojnë, është 20 herë me efikas sa i përket harxhimit të energjisë se sa reciklimi i tyre, e kjo poashtu ndihmon që të mos prodhohen makina të reja në mënyrë të panevojshme. Gjithashtu, çmimi më i ulët i produkteve të ripërdorura ofron mundësi për qasje në teknologji, për ata që nuk mund t'lejojnë vetes të blejnë pajisje të reja.<sup>58</sup>

**- Nëse nuk funksionojnë, të shfrytëzohen mënyra adekuate për reciklimin e tyre të sigurt.** Pajisjet e padëshiruara elektronike nuk duhet të hihen në bërllok, por ato duhet t'u jepen recikluesve të përgjegjshëm dhe të licencuar – atyre që nuk i eksportojnë, nuk i djegin ose nuk i hedhin në deponi. Kjo mund të bëhet nëpërmjet sistemit kombëtar për menaxhim me e-mbeturinat (nëse ekziston një sistem i tillë), ose nëpërmjet vetë prodhuesve, disa prej të cilëve i marrin produktet e tyre. Nëse nuk ekziston asnjëri nga këto opsione, konsumatorët mund t'ia kthejnë pajisjen elektronike prodhuesit, pa marrë parasysh se çka do të ndodhë, duke u dhënë në këtë mënyrë një porosi të qartë “për t'i marrë prapa pajisjet e tyre elektronike”.

<sup>54</sup> Kjo ka të bëjë me ata prodhues që marrin pjesë dhe përfitojnë nga sistemi Përgjegjësisë së zmadhuar të prodhuesit (PZP), pa mos dhënë kontribut financiar (ose të ndonjë llojit tjetër) për të, siç mund të ndodhë me prodhuesit e produkteve dhe komponenteve pa brend

<sup>55</sup> Widmer dhe të tjerët. 2005

<sup>56</sup> Shih, p.sh. EEB 2009

<sup>57</sup> Greenpeace 2008b

## Si t'i shndërrojmë këto zgjidhje në realitet?

### Lobimi për përfaqësim për e-mbeturinën në praktikë

#### Qasjet dhe aktivitetet për përfaqësim

Përfaqësimi është veprimi i përpjekjes për të shkaktuar ndryshime pozitive të politikave ose në praktikë (Kutia 6). Për ta bërë këtë, mund të shfrytëzohen qasje dhe aktivitete nga më të ndryshmet, duke filluar nga bashkëpunimi dhe të punuarit së bashku me vendimmarrësit, të bërit kritikë të hapur, madje edhe konfrontimi sa i përket politikave dhe praktikave.

#### Kutia 6. Ç'është përfaqësimi?

Përfaqësimi është aktiviteti me të cilin përpiqemi të shkaktojmë ndryshim pozitiv. Është më tepër se vetëm ngritja e vetëdijes për ndonjë problem të caktuar. Thënë më qartë, siç sqaron Chandleri, përfaqësimi ka për qëllim:

- të ndikojë mbi politikave dhe praktikave publike ose ato të kompanive;
- të ndikojë mbi qëndrimin dhe sjelljen publike;
- të ndikojë mbi proceset e vendimmarrjes duke i përfshirë komunitetet e ndikuara; dhe/ose,
- të aftësohen komunitetet e ndikuara që të mund të ndikojnë mbi vendimet që ndikojnë në jetën e tyre

Përfaqësimi mund të ketë më tepër forma, duke i përfshirë:

- Pjesëmarrjen në proceset (e përcaktuara) të konsultimeve gjatë miratimit të politikave
- Pjesëmarrjen në rrejetet e politikave jashtë proceseve formale të vendimmarrjes
- Lobimin të vendimmarrësit dhe/ose ata që mund të ndikojnë tek ata
- Ndryshimin e mendimit publik
- Aktivizmin: mobilizimi i përkrahësve për t'i paraqitur brengat e tyre para vendimmarrësve

Burimi: 1. Chandler 2010

#### Konsultimet

Konsultimet janë qasje e llojit bashkëpunues që nënkupton pjesëmarrje në procesin e përcaktuar të konsultimeve. Një organizatë mund të përfshihet në të për shkak se vendimmarrësit e kanë identifikuar atë si palë kyçe dhe/ose ekspert i njohur ose autoritet i njohur për temën. Ja disa shembuj të kësaj qasjeje të përdorura nga OJQ-të gjatë përfaqësimit për e-mbeturinën:



• **Rrjeti për veprim i Bazelit - Basel Action Network (BAN):** BAN-i është i pranuar si autoritet udhëheqës për e-mbeturinën nga ana e Programit të mjedisit jetësor të KB-ve (UNEP). Për këtë arsye, BAN-i e ka pasur mundësinë që të ndikojë mbi vendimet kyçe të Ministrisë dhe shpesh të veprojë si OJQ eksperte për sjellje të vendimeve.



- **Rrjeti për ripërdorimin e mobiljeve - Furniture Reuse Network (FRN):** FRN, që paraqet një koalicion të firmave në Mbretërinë e Bashkuar, ka luajtur një rol aktiv në procesin e konsultimeve gjatë bartjes së Direktivës për MPEE në legjislacionin e Mbretërisë së Bashkuar. Pjesëmarrja e tyre ishte shumë e rëndësishme në ripërdorimin e të gjitha pajisjeve të përcaktuara për rikthim, në rregullativat e Mbretërisë së Bashkuar.

### Demonstrimi i zgjidhjeve

Demonstrimi i zgjidhjeve është një qasje që bazohet në edukim, ku nëpërmjet hulumtimit dhe punës në ndonjë projekt, organizata prezanton zgjidhje të qëndrueshme dhe/ose demonstroi “praktika më të mira” që të ndikojë në procesin e sjelljes së vendimeve. Për shembull:

- **Rrjeti për veprim i Bazelit:** BAN ka përgatitur një model të kornizës ligjore nacionale për tregtinë me mbeturina toksike për vendet në zhvillim. Gjithashtu, i demonstroi praktikën më të mira për atë se si vendet duhet të ballafaqohen me problemin e mbeturinave toksike.
- **Computer Aid International:** Computer Aid ka përgatitur një Udhëzues për MPEE, i cili i sqaron përmasat e kornizës ligjore të BE-së për e-mbeturina dhe si bizneset mund ta respektojnë atë. Computer Aid, poashtu ka përgatitur edhe një numër të madh të raporteve speciale që kanë të bëjnë me e-mbeturinat dhe çështjet e tjera nga fusha e TKI-së.

### Analiza e politikave

Analiza e politikave është një qasje paksa konfrontuese, që përfshin analizë të politikave aktuale qeveritare, potencimin e gabimeve dhe dhënien e rekomandimeve. Për shembull:

- **Greenpeace International, Miqtë e Tokës (Friends of the Earth) dhe Byroja Evropiane e Mjedisit Jetësor (European Environmental Bureau):** Këto organizata e angazhuan Institutin ndërkombëtar për industri ekologjike ekonomike dhe Universitetin e Lundit që ta studiojnë implementimin e përgjegjësisë individuale të prodhuesve të paraparë në Direktivën për MPEE dhe ndikimin e përgjegjësisë individuale të prodhuesve mbi inovacionet dhe prodhimin e produkteve ekologjike. Këto dy grupe të hulumtimit ofrojnë udhëzim të informuar për politikën që kanë të bëjnë me kornizën ligjore për MPEE dhe qasjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave.
- **Qendra për hulumtim të korporatave ndërkombëtare (SOMO):** Artikulli i SOMO-s për politikën për e-mbeturina, qeverive evropiane, sektorit të elektronikës dhe OJQ-ve, u ofron një pasqyrë të politikave dhe praktikave aktuale për menaxhim me e-mbeturinat. Raporti jep rekomandime për atë se si Direktiva për MPEE mund të bëhet më efektive.



## Partneritetet

Bashkëpunimi me partnerë ose bashkëpunimi në kuadër të rrjeteve ofron mundësi për këmbim të ekspertizës dhe të njohurive, me ç'rast rriten kapacitetet e organizatave të përfshira. Partneriteti ndërmjet sektorëve të ndryshëm është një mundësi për të arritur deri te një publik më i madh. Gjithashtu, kur më tepër se një organizatë angazhohen për ndonjë çështje, kjo mund të shkaktojë vëmendje dhe urgjencë më të madhe. Për shembull:

- **Qendra për hulumtim të korporatave ndërkombëtare (SOMO):** Artikulli i SOMO-s për politikën për e-mbeturina, qeverive evropiane, sektorit të elektronikës dhe OJQ-ve, u ofron një pasqyrë të politikave dhe praktikave aktuale për menaxhim me e-mbeturinat. Raporti jep rekomandime për atë se si Direktiva për MPEE mund të bëhet më efektive

## Ngritja e vetëdijes

Përpjekjet për ndryshimin e mendimit publik dhe ngritjen e vetëdijes për situatën, mund të inicojnë ndonjë aktivitet dhe në këtë mënyrë të bëjë shtypje mbi vendimmarrësit. Kjo mund të bëhet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, duke e përfshirë edhe punën me medime, fushatat dhe ngjarjet.



Mund të jetë edukative, mirëpo mund të jetë edhe konfrontuese, në shkallë të ndryshme – shembull më provokativ janë “iniciativat për emërtim dhe turpërim”, me të cilat potencohet sjellja negative e qeverive dhe e korporatave, të cilat përpiqeni t'i ndryshoni. Për shembull

- **MakelTFair:** MakelTFair është projekt evropian që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes së të rinjve për çështjet sociale dhe të mjedisit, që ndërlidhen me pajisjet e tyre elektronike. Nëpërmjet fushatave dhe publikimeve të ndryshme, ata përpiqen që t'i aktivizojnë të rinjtë në organizimin e fushatave kundër keqpërdorimit të punës dhe menaxhimit jo të sigurt të mbeturinave.

- **Koalicioni Silicon Valley Toxics:** Në vitin 2008, ky koalicion udhëtoi për në Delhi, Indi, për ta dokumentuar jetën e atyre që në tregtinë me mbeturinat janë në anën e pranuesit. Ata inçizuan një video për kushtet e rrezikshme në të cilat punojnë recikluesit joformalë të e-mbeturinave në Indi. ‘Qytetarët në rrezik: Si mbeturinat elektronike e helmojnë daljen nga varfëria të recikluesve indianë’ është një video që ka për qëllim të krijojë vetëdije dhe të inicojë veprim për ndërprerjen e tregtisë me e-mbeturina.

- **Greenpeace:** Që në njëfarë mënyre ta tërheqë vëmendjen e korporatave të cilat kanë politika negative ekologjike, Greenpeace e përgatiti “Udhëzuesin për pajisje elektronike ekologjike”. Aty janë ranguar 18 prodhuesit më të mëdhenj të pajisjeve elektronike, sipas politikave të tyre për kemikatet toksike, për reciklim dhe për ndryshimet klimatike. Duke i publikuar aktivitetet e tyre, por gjithashtu duke i përshëndetur politikën e drejta, Greenpeace shpreson se në këtë mënyrë do t'i inkurajojë të gjitha kompanitë t'i pastrojnë produktet e tyre dhe të marrin përgjegjësi pas daljes së tyre nga përdorimi.

## Mobilizimi i opinionit publik

Mobilizimi i një numri të madh të njerëzve për një çështje të caktuar mund t'i bindë vendimmarrësit ta shohin atë dhe të bëjnë ndryshime. Për shembull:

- **Computer Aid International:** Në vitin 2008, Computer Aid ia dorëzoi një petition me mbi 700 nënshkrime qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, që t'i bindë vendimmarrësit të iniciojnë politika më të ashpra sa i përket eksportit joligjor të e-mbeturinave. Peticionet e tërhoqën vëmendjen e një numri të madh të njerëzve të cilët besojnë në ndonjë çështje të caktuar. Ato poashtu e shtojnë presionin mbi vendimmarrësit që të shohin më mirë dhe ta vërejnë problemin.

## Krijimi i mënyrave që njerëzit të mund të veprojnë vetë

Kjo ka të bëjë me mënyrat në të cilat njerëzit mund të përfshihen si aktorë për të bashkëpunuar dhe për të ndihmuar në përmbushjen e përpjekjeve tuaja për përfaqësim. Për shembull, vënia në ueb-faqe dhe buletine e veprimeve të thjeshta ose e shembujve të aktiviteteve mund t'i inkurajojë përkrahësit që të përfshihen edhe ata.

- **Koalicioni Electronics Take Back (ETBC):** ETBC ka një seksion në ueb-faqen e tyre ku vizitorëve u tregohet se si mund t'i bashkangjiten fushatës së tyre. Veprimet e thjeshta përfshijnë dërgimin e porosive deri te përfaqësuesit qeveritarë, gjetjen e recikluesve lokalë ekologjikë, ose vetëm të qenit i informuar.

## Lobimi

Lobimi paraqet veprimin e përpjekjes për të ndikuar te vendimmarrësit për ndonjë çështje të caktuar. Kjo mund të bëhet nëpërmjet takimeve të drejt-përdrejta, shkruarjes së letrave ose thirrjeve telefonike.<sup>59</sup> Për shembull:

- **Këshilli për Mbrojtjen e Resurseve Kombëtare:** Në Nju Jork, SHBA – së bashku me organizatat e tjera ekologjike, ata arritën të kenë sukses në përpjekjet e tyre që një ligj i ngjashëm për e-mbeturina të miratohet në Parlamentin Shtetëror.

- **Computer Aid International:** Mbretëria e Bashkuar shumë vonë e shndëroi Direktivën për MPEE të BE-së në ligj shtetëror. Computer Aid lobi që çështja për e-mbeturinat të hyjë në mendjet e deputetëve. Në vitin 2004 ata e patën prezantimin e parë për këtë temë, në dhomën e epërme të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Që atëherë, Computer Aid ka kontribuar në organizimin e takimeve konsultative për rregullativat në Mbretërinë e Bashkuar që kanë të bëjnë me MPEE. Ata, gjithashtu, ishin nikoqirë të diskutimit në formë të tryezës së rrumbullakët për këtë legjislacion, së bashku me vendimmarrësit dhe palë të tjera. Kjo, në kombinim me lobimin e OJQ-ve të tjera, solli deri te përfshirja e ripërdorimit në qëllimet për trajtim të mbeturinave.

## Veglat për përfaqësim


Ka shumë vegla që mund të shfrytëzohen për ta mbështetur fushatën tuaj për përfaqësim. Kur mendoni se cilat vegla t'i shfrytëzoni, duhet të mendoni për publikun që e keni për qëllim dhe si mund të ndikohet në mënyrën më të mirë mbi ta.



## Videot

Edhe pse mund të jenë të shtrenjta për t'u inçizuar, videot janë vegël e shkëlqyeshme për ngritjen e vetëdijes dhe për mobilizim për veprim. Sot, me numrin e madh të ueb-faqeve për shpërndarje të videove siç është YouTube, filmat e shkurtër mund të shpërndahen shumë dhe ato mund t'i shohin, mijëra, madje edhe miliona, njerëz.

• **Tregimi për aparatet tona (The Story of Stuff):** Projekti “Tregimi për aparatet tona” (The Story of Stuff) inçizoi një animacion të shkurtër (Fotografia 5) për t'i mësuar njerëzit për mentalitetin e prodhuesve të pajisjeve elektronike “dizajno për të hedhur”. Me pamje shumë të bukur grafike, kjo video është e lehtë për t'u parë dhe lehtë mund të gjendet, e poashtu ofron një numër të madh informatash, vetëm për disa minuta.



**Figura 5.** Tregimi për pajisjet elektronike, një film i animuar nga Projekti “Tregimi për aparatet tona”. (Shih: [www.storyofstuff.com/electronics](http://www.storyofstuff.com/electronics))

Shumë organizata të tjera e kanë shfrytëzuar videon si vegël, duke i përfshirë edhe Greenpeace-in dhe BAN-in.

### Shfaqje për ngritje të vetëdijes

Një mënyrë tjetër për ngritje të vetëdijes për ndonjë çështje të caktuar është shfaqja dramatike vizuale. Një ngjarje publike ose ndonjë shfaqje ka mundësi të shihet nga një numër i madh njerëzish, posaçërisht nëse shfaqet në ndonjë hapësirë publike me frekuencë të madhe të njerëzve. Mediumet, poashtu, mund ta pëlqejnë shfaqen, me ç'rast çështja juaj do të fitojë publicitetin edhe më të madh.



**Figura 6.** 'Njeriu MPEE' shtatë metra i gjatë i Shoqatës Mbretërore të Arteve. (Shih: <http://weeeman.org>)

- **Njeriu MPEE:** Për ta ngritur vetëdijen publike për e-mbeturinën dhe për ta ndryshuar sjelljen, Shoqata mbretërore e arteve e krijoi dhe e prezantoi nëpër Londër 'Njeriun MPEE' - një konstrukcion prej mbi tre tonë mbeturinash elektronike, me lartësi prej shtatë metrash (Fotografia 6). Njeriu MPEE është ndërtuar me sasinë e e-mbeturinave që një britanez mesatar e krijon gjatë jetës së tij.

- **'Televizorët zombi':** ETBC po zhvillon fushatë e cila ka për qëllim që prodhuesit të marrin përgjegjësi për produktet e tyre pas daljes së tyre nga përdorimi.

Si pjesë e kësaj, organizuesit e fushatës së ETBC-së mbajtën një shfaqje për ta ngritur vetëdijen për atë se si kalimi në sferën digjitale do ta rrisë sasinë e e-mbeturinave nga televizorët analogë që ende funksionojnë. Në shfaqje, ata u veshën si 'televizorë zombi' (Figura 7) për të insistuar që prodhuesit t'i marrin prapë dhe t'i reciklojnë televizorët e tyre të vjetër.



**Figura 7.** Shfaqja 'Televizorët zombi' e koalicionit Electronics Take-Back. (Shih: <http://bit.ly/ETBCTVzombies>).

## Raportet

Raportet janë vegël e mirë për të dhënë mendime specialiste, autoritative për ndonjë çështje të caktuar. Ato mund të përdoren si pjesë e ndonjë fushate për lexim plotësues dhe si përkrahje në prapavijë, ose si këshillë për miratim të politikave nga vendimmarrësit.

- **Computer Aid International:** Computer Aid ka publikuar një seri të Raporteve speciale për TKI dhe për mjedisin, të cilat përfshijnë çështje të ndryshme, siç janë, ripërdorimi, Direktiva MPEE dhe përgjegjësia e zmadhuar e prodhuesve. Këto raporte ofrojnë një pasqyrë koncize të çështjeve kyçe, me rekomandime për politikatat dhe praktikatat.

OJQ të ndryshme i shfrytëzojnë raportet për t'i potencuar çështjet që kanë të bëjnë me e-mbeturinat dhe për të demonstruar zgjidhje të ndryshme; shih 'Resurset dhe informata plotësuese' për më tepër detaje.

## Mediumet dhe komunikimet

• **Ueb-faqet dhe mediumet sociale.** Interneti dhe mediumet sociale janë bërë vegla të pazëvendësueshme për përfaqësim. Ueb-faqet për fushata janë vegël e dobishme për të komunikuar me përkrahësit, ofrojnë mundësi për fushata me një klik, dhe janë të dobishme si vegla për shpërndarje të burimeve. Bloget u mundësojnë t'i anashkaloni mediumet masovike tradicionale dhe ato mund t'i integroni në ueb-faqen tuaj. Duke e integruar prezencën tuaj në internet me mediumet sociale, si p.sh. në Facebook ose Twitter, i jepni dukshmëri më të madhe punës suaj.



**Figura 8.** Disa nga mundësitë e shumta të mediumeve sociale që i kanë në dispozicion ekipet për përfaqësim.

### **Kutia 7. Disa shembuj të 'shprehjeve që tingëllojnë bukur' për përfaqësim gjatë menaxhimit me e-mbeturina**

1. Duhet ta pengojmë valën toksike: Parashihet se deri në vitin 2020, për çdo vit BE-ja do të prodhojë mbi 12 milionë tonë e-mbeturina.
2. Prodhuesit duhet të ndalen së dizajnuari me qëllim të prishjes së shpejtë: 24% e laptopëve do të prishen në tre vitet e para si pasojë e problemeve harduerike.
3. S'ka më eksport ose import të materieve toksike: në vendet në zhvillim, më pak se 1% e e-mbeturinave reciklohen në mënyrë të sigurt.
4. Mos lejoni që pajisjet tuaja elektronike të përfundojnë si mbeturina: një ton kompjuterë përmban më shumë ar se sa që mund të nxirret prej 17 tonë xeheve të arit.
5. T'i largojmë materiet toksike prej pajisjeve tona: Televizorët dhe monitorët CRT, mund të përmbajnë prej dy deri në katër kilogramë plumb. Por, plumbi është biznes vdekjeprurës. Ekspozimi ndaj tij shkakton dëmtime në tru të fëmijët dhe tashmë është ndaluar te shumë produkte të konsumatorëve.

Burimet: 1. Universiteti i KB-ve 2007; 2. dhe 5. ETBC 2010a dhe b; 3. UNIDO 2009; 4. Grossman 2010

Këto mediume mund të përdoren për t'i ndarë fushatat, lajmet dhe fotografitë me një publik të gjerë që e përdor teknologjinë. Duke u dërguar mesazhe të shkurta dhe të shpeshta përkrahësve tuaj, do t'i mbani ata të interesuar dhe të gatshëm që t'u ndihmojnë.

• **Mediumet tradicionale 'masovike'.** Edhe pse interneti dhe mediumet sociale po shfrytëzohen gjithnjë e më shumë nga organizuesit e fushatave, komunikimi nëpërmjet burimeve 'tradicionale' të lajmeve, siç janë gazetatat, televizioni dhe radioja, mbetet si mënyrë kyçe për bartjen e porosisë suaj, për ndryshimin e qëndrimeve dhe për mobilizimin e përkrahjes për çështjen tuaj. Mediumet masovike, gjithashtu kanë ndikim të fortë mbi vendimmarrësit kyç dhe në këtë mënyrë paraqesin faktor të rëndësishëm dhe me ndikim, që ju duhet t'i keni për qëllim në përpjekjet tuaja për përfaqësim.

**Njoftimet për mediumet dhe konferencat për shtyp** janë vegla të mira për ta fituar vëmendjen e mediumeve. Njoftimet për mediumet mund të kenë qëllime të ndryshme, duke përfshirë paralajmërimin e ndonjë ngjarjeje, lajmërimin e fushatave të reja, të kritikuarit ose komentimin e vendimeve qeveritare. (Për këshilla se si ta shkruani një njoftim për mediumet shihni Doracakun e WaterAid (WaterAid Sourcebook.<sup>60</sup>)

Dhënia e **intervistave** në televizion, radio ose në mediumet e shtypura është një mënyrë me vlerë të jashtëzakonshme për ta bartur porosinë tuaj. Njohja e mirë e temës është shumë me rëndësi. Poashtu, kyçe është edhe gjuha që do ta përdorni, si edhe prezantimi i përgjithshëm, veçanërisht në televizion dhe në radio. Doracaku i WaterAid (WaterAid Sourcebook)<sup>61</sup> ka një listë të dobishme të gjërave që “duhet dhe atyre që nuk duhet bërë”, kur komunikohet me mediumet. Është e dobishme që t’i keni të parapërgatitura disa ‘shprehje që tingëllojnë bukur’ (pjesë të shkurta nga intervista të mëparshme). Ato janë deklarata tërheqëse, që e nënvizojnë pozicionin tuaj të përfaqësimit me ndonjë fakt të dobishëm. Disa shembuj janë dhënë në Kutinë 7.

Veglat e tjera për mediumet masovike i përfshijnë **shkrimet** (mendimet ose komentet në ndonjë gazetë) dhe **letrat për redaktorin** në gazeta.

## Materialet promovuese

**Fletëpalosjet, paketat me informata dhe paketat për shtyp, buletinet, posterët** dhe materialet e tjera promovuese janë pjesë shumë e rëndësishme e një fushate për mobilizim. Ato duhet të jenë dizajnuara në atë mënyrë që do ta tërheqin vëmendjen, duhet të jenë informative, por duke mos përdorur shumë fjalë dhe duhet ta paraqesin në mënyrë të qartë “ftesën për veprim”.<sup>62</sup> Ja disa shembuj:

- **MakeITFair**: Si pjesë e fushatës së tyre për mobilizimin e të rinjve, për ngritjen e vetëdijes së tyre për atë se prej nga vijnë aparatet e tyre dhe për të ndërmarrë aktivitetet për pastrimin e zinxhirit furnizues të pajisjeve elektronike, MakeITFair publikoi një seri fletëpalosjesh për çështjet kyçe të punës dhe të mjedisit në prodhimtarinë e pajisjeve të TKI. Fletëpalosjet kanë përmbajtje grafike interesante, dhe gjuhë të thjeshtë, por emotive, të mbështetur me raste studimi, ku jepen emrat dhe tregimet e vërteta të punëtorëve të fabrikave që i prodhojnë aparatet tona, shpesh në kushte të këqija dhe me rroga të ulëta.

## Njerëzit e famshëm

Në qoftë se keni njerëz të famshëm që e përkrahin fushatën tuaj, ata mund të tërheqin vëmendje dhe publicitet të madh. Njerëzit e famshëm duhet të zgjidhen jashtëzakonisht me kujdes, sepse në qoftë se zgjedhni dikë që është shumë pak i interesuar për çështjen që e përfaqësoni, dhe vetëm dëshiron të fitojë publicitet, mund ta rrezikojë kredibilitetin e organizatës.

<sup>60</sup> WaterAid 2003

<sup>61</sup> WaterAid 2003

<sup>62</sup> WaterAid 2003



• **OJQ Ngritja e shpresës për Kongon (Raise Hope for Congo):** Në një parodi të përgatitur me mjeshtëri, të një reklame mjaft të njohur të gjigantit të pajisjeve elektronike Apple, OJQ Ngritja e shpresës për Kongon, përdori dy njerëz të famshëm televizivë (dy aktorë të famshëm në SHBA) për t'i informuar shikuesit për shkeljen e të drejtave të njeriut në zinxhirin e furnizimeve të kompanive për teknologji moderne, të cilat mbështeten në lëndët e para nga vendet e shkatërruara nga lufta në Afrikë dhe vende të tjera.



**Figura 9.** Njerëz të famshëm në një reklamë 'hokatare' të OJQ-së "Ngritja e shpresës për Kongon". (Shih: [www.raisehopeforcongo.org](http://www.raisehopeforcongo.org))

## Resurset dhe informatat plotësuese

### Instrumentet kyçe ligjore dhe politike

#### Direktiva 2002/96/KE për MPEE

**Direktiva për Mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike** (Direktiva për MPEE) është instrumenti kryesor ligjor evropian për e-mbeturinat. Direktiva për MPEE ka për qëllim ta pengojë gjenerimin e mbeturinave dhe ta promovojë ripërdorimin, reciklimin dhe format e tjera të rikthimit, për ta zvogëluar sasinë e e-mbeturinave të hedhura. Direktiva i përfshin 10 kategori të gjera të pajisjeve elektrike dhe elektronike<sup>63</sup> (Kutia 8). U vendos një qëllim vjetor që të mblidhen 4kg mbeturina për një person, që duhej rishqyrtuar në vitin 2008. Pajisjet specifike për rikthim janë përcaktuar në bazë të 10 kategorive të produkteve; prioritet duhet t'i jepet ripërdorimit të pajisjeve të tëra. Prodhuesit duhet t'i mbulojnë harxhimet financiare të prodhimeve të tyre pas daljes nga përdorimi, kurse konsumatorët duhet jenë në gjendje t'i kthejnë pajisjet e tyre të vjetra elektronike pa asnjë pagesë.

Kjo përgjegjësi e prodhuesit është vendosur si një nga mënyrat për të inkurajuar ndryshime pozitive gjatë dizajnit, me qëllim që të arrihen qëllimet e Direktivës. Shqyrtimi i Direktivës në vitin 2008 identifikoi disa probleme kyçe sa i përket implementimit të saj. Prandaj, Direktiva gjendet në një proces të revizionit, për ta përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin e saj. Për më tepër informata, shih <http://ec.europa.eu/environment/waste/wEEE/>.

#### Kutia 8. Kategoritë e produkteve të Direktivës MPEE

1. Aparatet e mëdha shtëpiake
2. Aparatet e vogla shtëpiake
3. Pajisjet për TI dhe telekomunikim
4. Pajisjet për elektronikë zbavitëse
5. Pajisjet për ndriçim
6. Mjetet elektrike dhe elektronike
7. Lojërat, pajisjet për kohë të lirë dhe sport
8. Aparatet medicinale
9. Instrumentet për mbikëqyrje dhe kontroll
10. Automatet

<sup>63</sup> Si pajisje elektrike dhe elektronike, ose PEE, definohet çdo pajisje, e cila për të punuar në mënyrë adekuate varet nga rryma elektrike ose fushat elektromagnetike, dhe këtu përfshihen pajisjet për gjenerim, transfer dhe matje të këtyre rrymave dhe të cilat janë të dizajnuara për përdorim, me voltazh jo më të madh se 1000 volt, për rrymë të ndryshueshme dhe 1500 volt për rrymë të vazhdueshme.



Direktiva e BE-së për Kufizimin e materieve të rrezikshme (DKMR) u miratua në vitin 2003, mirëpo hyri në fuqi në korrik të vitit 2006. Ajo ka për qëllim ta kufizojë përdorimin e disa materieve të rrezikshme të pajisjet elektrike dhe elektronike. Në këtë mënyrë, rritet mbrojtja e shëndetit të njerëzve dhe ndihmohet trajtimi i e-mbeturinave në mënyrë që nuk e dëmton mjedisin jetësor. Vendet anëtare duhet të miratojnë kornizë ligjore nacionale për kufizimin e përdorimit të katër metaleve të rënda (plumbit, kadmiumit, zhivës dhe kromit heksivalent) dhe dy grupeve të materialeve zjarrduruese me brom (PBB dhe PBDE) në prodhimin e pajisjeve të reja elektronike (edhe pse ekzistojnë përjashtime për përdorime të caktuara të këtyre substancave, derisa të gjenden zëvendësime). Direktiva ka ndikim global për shkak se i trajton edhe produktet që importohen në BE, e jo vetëm ato që janë prodhuar brenda kufijve të saj.

Me revizionin e paradokohshëm të Direktivës, u zgjerua diapazoni i saj, me të cilin tani përfshihen të gjitha pajisjet e elektronike, përveç nëse nuk janë përfshuar në mënyrë të eksplicite. Për më tepër informata, shih <http://ec.europa.eu/environment/waste/weee/>.

### Kutia 9. Instrumentet ligjore për e-mbeturina në Ballkanin Perëndimor

Katër vendet e përfshira në Rrjetin ballkanik për përfaqësim gjatë menaxhimit me e-mbeturinën, Bullgaria, Kroacia, Serbia dhe Maqedonia, në shkallë të ndryshme kanë vendosur instrumente ligjore që kanë për qëllim ta minimizojnë ndikimin e pajisjeve elektronike dhe të e-mbeturinave. Më poshtë, ato janë përshkruar shkurtimisht:

- **Bullgaria:** siç kërkohet nga një vend anëtar i BE-së, Bullgaria e ka transponuar edhe Direktivën për MPEE edhe atë DKMR, nëpërmjet Urdhëresës për kërkesat për futjen e PEE në treg, si dhe për trajtimin dhe transportimin e MPEE (Gazeta zyrtare nr. 36/2006). Urdhëresa ka hyrë në fuqi më 1 shtator 2006.
- **Kroacia:** si vend kandidat për anëtarësim në BE, Kroacia i transponoi Direktivat MPEE dhe DKMR në vitin 2007, nëpërmjet Urdhëresës për mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike (me amendamente në vitin 2008 dhe 2009). Pas miratimit të Urdhëresës (Gazeta zyrtare nr. 74/07, 133/08, 31/09) dhe pas procedurës për furnizim publik, Ministria u ka ndarë koncesione kompanive që do t'i mbledhin dhe do t'i trajtojnë e-mbeturinën.
- **Maqedonia:** Ligji i Maqedonisë për menaxhim me mbeturinat i vitit 2004, ka definicione për "mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe elektronike" dhe disa obligime konkrete për shitësit, prodhuesit ose importuesit dhe konsumatorët e pajisjeve elektronike. Këtu përfshihet edhe kërkesa që kompanitë elektronike të ofrojnë shërbime të reciklimit për pajisjet e përdorura. Megjithatë, shumica e kompanive nuk janë të njoftuara me këto rregulla, ose nuk i respektojnë për shkak të shkallës së ulët të zbatimit të tyre nga ana organeve kompetente. Tani, në përgatitje e sipër është ligji që do të bazohet në Direktivën për MPEE.
- **Serbia:** Ligjet aktuale për menaxhim me mbeturinat e rrezikshme dhe ato të parrezikshme në Serbi janë të vjetëruara dhe nuk përputhen me kërkesat dhe standardet më të reja të BE-së që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor. Që nga viti 2004, është e ndaluar të importohet çfarëdo qoftë pajisje e vjetër teknike ose e TI, për shkak të frikës që Serbia të mos bëhet deponi për e-mbeturinën e vendeve të tjera.

Megjithatë, instrumentet aktuale ligjore dhe /ose implementimi i tyre nuk arrijnë që ta zgjidhin në mënyrë adekuate problemin me e-mbeturinën në tërë rajonin. Vendet e OECD-së shpesh e kanë si synim Ballkanin për largimin e e-mbeturinave të tyre, e poashtu edhe praktikën për trajtimin e e-mbeturinave të prodhuara në nivel lokal mbeten të pakënaqshme. Sa i përket resurseve njerëzore dhe financiare, që i dedikohen menaxhimit të e-mbeturinave, praktikën aktuale në rajon janë substandarde, me mbikëqyrje dhe zbatim të pamjaftueshëm dhe jo efektiv të rregullave ekzistuese. Poashtu, ekziston vetëdije e ulët për këtë çështje në mesin e vendimarrësve dhe publikut të gjerë, kurse statistikat zyrtare në lidhje me sasinë, burimet dhe mënyrat e largimit të e-mbeturinave janë të pakta ose nuk ekzistojnë fare. Këta faktorë kontribuojnë për problemet me menaxhimin e e-mbeturinave në rajon. (Për më tepër informata, shih <http://www.e-otpad.mk/>)

## Direktiva 2009/125/KE për produktet që shfrytëzojnë energji

Direktiva për përcaktimin e kornizës për vendosjen e kërkesave për ekodizajn të prodhimeve që shfrytëzojnë energji (Direktiva EuP ) ka për qëllim t'i përmirësojë performansat ekologjike të produkteve gjatë tërë ciklit të tyre jetësor, nëpërmjet integritit sistematik të aspekteve ekologjike në fazën e dizajnit të prodhimeve (d.t.th. ekodizajnit).

Kjo Direktivë, nuk ka dispozita të drejtpërdrejta për kërkesat e domosdoshme për produktet e caktuara, por vetëm i definon kushtet dhe kriteret për përcaktimin e kushteve për çdo produkt veç e veç. Të gjitha kërkesat e domosdoshme për produktet konkrete do të përgatiten më vonë, nëpërmjet masave për implementim, të cilat do të zbatohen gjatë një procesi të konsultimeve dhe të vlerësimit të ndikimit.

Masat për implementim mund të jenë në forma të ndryshme, duke përfshirë rregullimin e obligueshëm, iniciativat vullnetare të industrisë etj. Deri tani janë miratuar një numër i madh i masave për implementim, duke i përfshirë edhe ato për kompjuterët dhe monitorët, televizorët, frigoriferët dhe frizat shtëpiakë, dhe ndriçimin shtëpiak.

Për më tepër informata, shih [http://bit.ly/EC\\_ecodesignEuP](http://bit.ly/EC_ecodesignEuP).

## Konventa e Bazelit

Konventa e Bazelit për Kontrollin e qarkullimit ndërkuftar të mbeturinave të rrezikshme dhe largimin e tyre, u miratua në mars të vitit 1989. Me futjen në përdorim të sistemit për kontrollimin e eksportit, importit dhe të largimit të mbeturinave të rrezikshme, Konventa ka për qëllim ta zvogëlojë sasinë e përgjithshme të këtyre këmbimeve, për ta mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin jetësor.

Njëri nga parimet udhëheqëse të Konventës është të minimizohen kërcënimet ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit jetësor, prandaj mbeturinat e rrezikshme duhet të trajtohen sa më afër vendit ku janë prodhuar.

"Amandamenti i ndalesës së Bazelit" hyri në fuqi në vitin 1998 dhe i përfshin të gjitha 175 shtetet anëtare të Konventës. Ai i ndalon të gjitha qarkullimet ndërkuftare të mbeturinave të rrezikshme nga vendet e anëtare të Organizatës për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (OECD), në vendet që nuk janë anëtare të OECD-së.

BE-ja e ka ratifikuar Konventën e Bazelit dhe Amandamentin e ndalesës, të implementuara nga Rregullivat për transport të mbeturinave 2006/1013/KE. Kjo do të thotë asnjë lloj i mbeturinave të rrezikshme, duke i përfshirë edhe e-mbeturinat, nuk guxon të eksportohet jashtë BE-së, për trajtim në vende që nuk janë anëtare të OECD-së.

Për më tepër informata, shih <http://www.basel.int>.

## Iniciativa të rëndësishme

### **Iniciativa StEP** [www.step-initiative.org](http://www.step-initiative.org)

Iniciativa për zgjidhje të problemit me e-mbeturinat - StEP (Solving the E-Waste Problem) bashkon anëtarë nga organizata të ndryshme të KB-ve, industria, qeveritë, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të dhe sektori shkencor, me qëllim që të vendosë qasje të qëndrueshme për trajtim të e-mbeturinave. StEP e zhvillon punën e saj në pesë grupe të punës, duke bërë analizë, planifikim dhe pilot projekte për: politika, redizajn, ripërdorim, reciklim dhe ngritje të kapaciteteve.

### **UNEP-PACE** [www.basel.int/industry/compartnership](http://www.basel.int/industry/compartnership)

Partneriteti për pajisje kompjuterike (PACE) u inicua në vitin 2008, në takimin e nëntë të Konferencës së Palëve të Konventës së Bazelit. Ai është një partneritet me shumë palë, që qeverive, udhëheqësve të degëve të ndryshme të industrisë, OJQ-ve dhe botës akademike u mundëson një forum për të gjetur zgjidhje ekologjike për pajisjet e larguara kompjuterike.

## OJQ-të që merren me çështjet e pajisjeve elektronike dhe të e-mbeturinave

### Rrjeti i për veprim Bazelit [www.ban.org](http://www.ban.org)

Rrjeti për Veprim i Bazelit (BAN) fokusohet për t'i dhënë fund tregtisë globale me mbeturina toksike, duke i përfshirë edhe e-mbeturinat. Ata kanë link për te raportet dhe filmat që i kanë inçizuar, e poashtu kanë edhe një numër të madh të materialeve të tjera në ueb-faqen e tyre.

### Computer Aid International [www.computeraid.org](http://www.computeraid.org)

Computer Aid International është një agjenci ndërkombëtare bëmirëse që inkurajon ripërdorimin e pajisjeve të TKI. Ata, gjithashtu angazhohen për të përfaqësuar në çështje që kanë të bëjnë me TKI dhe mjedisin jetësor, duke i përfshirë edhe e-mbeturinat. Në ueb-faqen e saj ka raporte dhe udhëzime për përzgjedhjen e partnerëve që janë të përgjegjshëm gjatë largimit të pajisjeve të TI.

### Byroja Evropiane për Mjedisin Jetësor [www.eeb.org](http://www.eeb.org)

Byroja Evropiane për Mjedisin Jetësor (EEB) është një federatë e organizatave të mjedisit, me diku rreth 140 anëtarë anembanë Evropës. Fokusi i saj është që të ndikojë në miratimin e politikave të BE-së, si dhe në implementimin dhe vlerësimin e politikave të miratuara, duke i përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me pajisjet elektronike dhe e-mbeturinat. Në ueb-faqen e saj mund të gjenden publikime të ndryshme.

**Koalicioni për rikthimin e pajisjeve elektronike [www.electronicstakeback.com](http://www.electronicstakeback.com)**

Ky koalicion nga SHBA-të, e promovon dizajnin ekologjik dhe reciklimin e përgjegjshëm në industrinë elektronike. Kanë përgatitur një numër të madh të materialeve, duke përfshirë edhe një libër njoftues me problematikën e e-mbeturinave, raporte dhe vegla të tjera për përfaqësuesit, dhe të gjitha këto gjenden në ueb-faqen e tyre.

**Greenpeace <http://bit.ly/GreenerElectronics>**

Greenpeace, një organizatë ndërkombëtare ekologjike, ka një fushatë për Pajisje elektronike ekologjike që ka për qëllim ta ndryshojë mënyrën se si prodhohen, përdoren dhe hidhen pajisjet elektronike. Udhëzuesi i Greenpeace-it për Pajisje elektronike ekologjike, si dhe raportet, videot dhe shumë materiale të tjera gjenden në ueb-faqen e kësaj organizate.

**MakeITFair <http://makeitfair.org/>**

MakeITFair është projekt evropian me të cilin të rinjtë inkurajohen të vetëdijësohen për prejardhjen e pajisjeve të tyre elektronike, si dhe për çështjet ekologjike dhe sociale që janë të përfshira në industrinë elektronike. Informata, raporte dhe materiale të tjera mund të gjenden në ueb-faqen e këtij projekti.

**SOMO <http://somo.nl/>**

Qendra për hulumtimin e korporatave ndërkombëtare (SOMO) është një byro holandeze për hulumtim dhe këshillim, e cila e hulumton globalizimin e tregtisë dhe të mbeturinave. Sikurse edhe MakeITFair, SOMO, poashtu e koordinon Good Electronics, që është një rrjet që fokusohet në çështjet e të drejtave të njeriut në industrinë elektronike. Detajet për këto aktivitete, si dhe artikuj për politika dhe materiale për pajisjet elektronike dhe e-mbeturinën, mund të gjenden në ueb-faqen e saj.

**Koalicioni Silicon Valley Toxics <http://svtc.org>**

Si përgjigje ndaj zhvillimit të shpejtë të industrisë së teknologjisë së lartë, koalicioni Silicon Valley Toxics realizon hulumtime, përfaqësim dhe aktivitete themelore për ta promovuar shëndetin e njeriut dhe drejtësinë ekologjike. Filmat, raportet dhe materialet e tjera të përgatitura nga ky koalicion mund të gjenden në ueb-faqen e tij.

**Toxics Link [www.toxicslink.org](http://www.toxicslink.org)**

Toxics Link është një OJQ ekologjike nga India, e cila përfaqëson për përforsimin e kornizës ligjore me të cilën ndalohen materiet toksike. Në kuadër të programit të tyre "Industria e pastër", ata kanë një numër të madh të materialeve që kanë të bëjnë me mbeturinat e rrezikshme dhe ato elektronike, të cilat mund të gjenden në ueb-faqen e saj.

# Referimet

- ACR (2003) The management of WEEE: a guide for local and regional authorities. Gjendet në: <http://bit.ly/9rygDR>
- BBC (2010) Europe breaking electronic waste export ban. Gjendet në: <http://bbc.in/hkIV0y>
- Chandler, I. (2010) Advocacy and Campaigning, How to Guide BOND. Gjendet në: <http://bit.ly/fzZDia>
- Computer Aid (2010) Special Report 1: Why reuse is better than recycling. Gjendet në: <http://bit.ly/dTgwGG>
- EEA (European Environment Agency) (2009) Waste Without Borders in the EU. Gjendet në: <http://bit.ly/gk8MVv>
- EEB (European Environmental Bureau) (2009) Blueprint for European Sustainable Consumption and Production: Finding the path of transition to a sustainable society. Gjendet në: <http://bit.ly/gTOIWI>
- EEB (2010) Designing greener electronic products: Building synergies between EU product policy instruments or simply passing the buck? Gjendet në: <http://bit.ly/fmwppk>
- Electronic TakeBack Coalition (ETBC) (2009) E-waste: the exploding global electronic waste crisis. Gjendet në: <http://bit.ly/enA1j4>
- ETBC (Electronics TakeBack Coalition) (2010a) Quickly Obsolete. Gjendet në: <http://bit.ly/hc2Tu7>
- ETBC (2010b) Facts and Figures of E- Waste and Recycling. Gjendet në: <http://bit.ly/gAEKIS>
- Empa (2009) E- Waste Definition. Gjendet në: <http://bit.ly/fetqb9>
- Enough Project (2011) Conflict Areas. Gjendet në: <http://bit.ly/f4lbf0>
- Environment Agency (2010) EEE Scope Guidance. Gjendet në: <http://bit.ly/gkDuBo>
- European Commission (2008) 810/4. Proposal for a Directive of the European Parliament and of the Council on waste electrical and electronic equipment. Gjendet në: <http://bit.ly/gtSTSO>
- European Commission (2010). Critical raw materials for the EU. Gjendet në <http://bit.ly/aXAc91>
- FAN (Freshwater Activist Network) (2010) Rights to Water and Sanitation: A handbook for Activists. Gjendet në: <http://bit.ly/g1UeKn>
- Fredholm, S. (2008) Evaluating Electronic Waste Recycling Systems: The influence of physical architecture on system performance. Gjendet në: <http://bit.ly/c1yS0l>
- Greenpeace (2005) What's in electronic devices. Gjendet në: <http://bit.ly/hTABYA>
- Greenpeace (2008a) Toxic Tech: not in our backyard. Gjendet në: <http://bit.ly/bypCx8>
- Greenpeace (2008b) Solutions. Gjendet në: <http://bit.ly/dSODry>
- Grossman E. (2006) High tech trash: digital devices, hidden toxics, and human health. Washington, D.C: Island Press.
- Grossman, E. (2010) Tackling high-tech trash: the e-waste explosion and what we can do about it Dēmos. Gjendet në: <http://bit.ly/cDlj7B>
- GRRN and SVTC (2008) Computer Takeback Goal Statement. Gjendet në: <http://bit.ly/gVMcr>
- IIIEE (The International Institute of Industrial and Environmental Economics) (2006a) Extended Producer Responsibility: an examination of its impact on innovation and greening products University of Lund, Sweden. Gjendet në: <http://bit.ly/eNFwz>
- IIIEE (2006b) Lost in Transposition: a study of the transposition of individual producer responsibility in the WEEE Directive. University of Lund, Sweden. Gjendet në: <http://bit.ly/erhqZ2>
- ITU (2009) The world in 2009: ICT facts and figures. Gjendet në: <http://bit.ly/ihTScN>
- Land, G. (2010) UK Government and European E-Waste Illegally Dumped in Africa. Gjendet në: <http://bit.ly/hpuW4f>
- Leonard, A. (2010) The Story of Electronics. Film. Gjendet në: <http://bit.ly/ibNPW8>
- McDonough, W and Braungart, M. (2002) Cradle to Cradle: Remaking the Way We Make Things. New York: North Point Press
- Nordbrand, S. (2009) Out of Control: E- waste trade flows from the EU to developing countries. SwedWatch. Gjendet në: <http://bit.ly/ej2iw0>
- Puckett, J. and Smith, T. (2002) Exporting Harm, the Hi-tech trashing of Asia. BAN and SVTC Gjendet në: <http://bit.ly/hrg10S>
- Raise Hope for Congo (2010) Conflict Minerals. Gjendet në: <http://bit.ly/hs3N0n>
- Reuters (2008) Gartner says more than 1 billion PCs in use worldwide and headed to 2 billion units by 2014. Gjendet në <http://bit.ly/bmZPr8>
- Schulep M. et al. (2009) Recycling: from E-waste to Resources. StEP Initiative, UN University-UN Environmental Programme
- SVTC (Silicon Valley Toxics Coalition) (2010). E-waste. Gjendet në: <http://svtc.org/our-work/e-waste/>
- UNEP (United Nations Environment Programme) (2005) Environment Alert Bulletin: E-waste, the hidden side of IT equipment's manufacturing and use. Gjendet në: <http://bit.ly/aEiWYY>
- UNIDO (2009) Reuse and Recycle: growing green businesses. Gjendet në <http://bit.ly/aTuf4p>
- UN University (2007) Review of Directive 2002/96/EC on waste electrical and electronic equipment (WEEE). Gjendet në: <http://bit.ly/gPxkLV>
- WaterAid (2003) Advocacy Sourcebook. Gjendet në: <http://bit.ly/h8XcR>
- Widmer R. et al. (2005) Global perspectives on e-waste. Env. Impact Asses. Rev. 25: 436-458.
- Williams, E. (2003) 'Environmental impacts in the production of personal computers' (pp. 41-72) in Williams, E. et al. (Eds.) Computers and the Environment: Understanding and Managing their Impacts. Dordrecht: Kluwer Academic Publishers
- Williams, E. (2004) Revisiting energy used to manufacture a desktop computer: hybrid analysis combining process and economic input-output methods. Electronics and the Environment. Conference Record. IEEE International Symposium
- Williams, E. et al. (2008) Environmental, social and economic implications of global reuse and recycling of personal computers. Environ. Sci Technol 42: 6446-54
- World Bank (2005) in Worldmapper: Televisions in use. Gjendet në: <http://bit.ly/fk80nb>

## Na p rkrasni



[www.facebook.com/bewman](http://www.facebook.com/bewman)



[twitter.com/bewman\\_eu](https://twitter.com/bewman_eu)



[flickr.com/photos/bewman](https://www.flickr.com/photos/bewman)



[linkedin.com/company/  
balkan-e-waste-management-advocacy-network](https://www.linkedin.com/company/balkan-e-waste-management-advocacy-network)



[youtube.com/user/bewmaneu](https://www.youtube.com/user/bewmaneu)





rrjeti ballkanik për përfaqësim gjatë menaxhimit të e-mbeturinave

Rrjeti ballkanik për përfaqësim gjatë menaxhimit me e-mbeturina është i financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa implementohet nga Fondacioni Metamorfozis – Maqedoni, si lider, në partneritet me BlueLink - Bullgari, Computer Aid – Mbretëria e Bashkuar, ZaMirNet – Kroaci dhe PROTEKTA – Serbi



# www.e-otpad.mk

CIP - Каталогизacija vo publikacija  
Nacionalna i univerzitetaska biblioteka "Св. Климент Охридски", Скопје

005.575:[628.4:621.38(036)]  
32.019.51:[628.4:621.38(036)]

BOWCOCK, Haley  
Pajisjet i elektronike dhe e-mbeturinat : ndhëzuesi për përfaqësim  
/ [autore Haley Bowcock ; redaktore Elena Ignatova]. - Skopje :  
Fondacija Metamorfozis, 2011. - 33 стр. : илустр. ; 20 см

Публикацијата е во рамките на проектот "Balkan e-waste management  
advocacy network". - Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 33

ISBN 978-608-4564-21-8

а) Е-отпад - Застапување и лобирање за справување - Водичи  
COBISS.MK-ID 89506058

